

1 E enjte, 9 dhjetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

4 --- Fillon në orën 9.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare,
6 ju lutem thërrisni çështjen.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Përshëndetje të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
11 Kemi ndonjë ndryshim në ekipin tuaj z. Pace?

12 Z. PACE: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar Gjykatës. I vetmi
13 ndryshim që kemi për sa i takon grupit tonë, është që kemi me
14 ne sot edhe Benjamin Dearden, i cili është stazhier ligjor.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
16 z. Pace.

17 Z. Rees.

18 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk kemi ndryshime.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
20 Z. Worboys.

21 Z. WORBOYS: As ne nuk kemi ndryshime.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
23 Neve shohim që z. Gucati dhe z. Haradinaj janë të pranishëm në
24 sallën e gjyqit.

25 Jemi gati që të fillojmë me dëshmitaren e radhës, që është

1 Taibe Miftari. Është dëshmitarja me numër 1241.

2 Znj. Sekretare, ju lutem shoqërojeni dëshmitaren në sallën e
3 gjyqit.

4 Z. REES: [Përkthim] Sa për t'ju informuar znj. Stephenson do
5 merret me këtë dëshmitare, do ta marrë në pyetje.

6 [Trupi gjykues dhe Sekretarja e gjykatës
7 këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka një vonesë
9 të shkurtër, disa minuta.

10 Znj. Stephenson ka qenë e pranishme edhe dje në Gjykatë. I
11 kërkova z. Rees që të lexonte deklaratën, me përjashtim të
12 paragrafëve që unë e udhëzoja atë që të mos i lexonte.

13 Megjithatë, e diskutuam edhe një herë këtë çështje dhe kemi
14 një ndryshim të vogël.

15 Së pari duam që t'i kërkoni dëshmitares që në qoftë se
16 deklarata e dhënë prej saj është e saktë në përputhje me
17 parashikimin e rregullës 154. Pastaj do të diskutojmë lidhur
18 me pranueshmërinë e dokumentit dhe më pas do të lexojmë të
19 gjithë dokumentin në qoftë se kjo pranohet. E kuptuat?
20 A keni ndonjë problem ju të prokurorisë lidhur me këtë
21 çështje?

22 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Në rregull.

23 ZONJA. STEPHENSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi problem.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi
2 znj. Miftari. Sekretarja tani do t'ju japë tekstin e një
3 deklaratë solemne, të cilën duhet ta lexoni në përputhje me
4 rregullin 141(2) i Rregullores. Ju lutem vijoni më tej.

5 DËSHMITARJA: E ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
6 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them
7 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
8 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

9 DËSHMITARJA: TAIBE MIFTARI

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem uluni,
11 znj. Miftari.

12 DËSHMITARJA: Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

14 Znj. Miftari, sot do të dëgjojmë deklaratën tuaj, dëshminë
15 tuaj. Siç e dini znj. Stephenson do të fillojë e para. Do t'ju
16 bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me deklaratën që keni dhënë.
17 Ndërkohë do të kemi një diskutim të shkurtër lidhur me
18 deklaratën tuaj dhe pasi e kemi bërë këtë diskutim, pjesa e
19 pranuar e deklaratës do të lexohet për proces verbal. Pastaj
20 znj. Stephenson do të bëjë më shumë pyetje në qoftë se ka.
21 Më pas avokatët që përfaqësojnë z. Haradinaj, mund t'ju bëjnë
22 disa pyetje. Pastaj do ti vij radha për pyetje Prokurorëve dhe
23 gjithashtu edhe anëtarët e Trupit Gjykes mund të kenë disa
24 pyetje për ju.

25 Vlerësohet që koha për sa i takon marrjes në pyetje të

1 drejtpërdrejtë mund të jetë 15 minuta për juve, por Prokuroria
2 ka kërkuar me shumë kohë. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje
3 të tjera plotësuese nga Mbrojtja, në qoftë se përmbushen
4 kushtet përkatëse.

5 Ju lutem, në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, kërkojini
6 avokates që ta thotë edhe një herë pyetjen, ta përsërisë edhe
7 një herë atë, ose që ta shpjegojë në një mënyrë tjetër. Po
8 ashtu ju lutem, mundohuni që të shpjegoni bazën e njohurive
9 dhe të rrethanave për të cilat do të pyeteni.

10 Ju lutem flisni përpara mikrofonit dhe mundohuni që të prisni
11 5 sekonda përpara se të jepni përgjigje një pyetje. Ju lutem
12 lexoni me ritëm të ngadaltë në mënyrë që të mund të kapin
13 plotësisht përkthyesit.

14 Ndërkohë që jepni dëshmi përpara këtij Trupi Gjykues, ju nuk
15 lejoheni që të diskutoni për përmbajtjen e kësaj dëshmie me
16 askënd. Në qoftë se ndonjë person jashtë kësaj salle gjyqi ju
17 kërkon ose ju bën pyetje lidhur me dëshminë, me deklaratën që
18 ju do të jepni, ju lutem na thoni.

19 Në rregull. Znj. Stephenson, fjala për ju.

20 Pyetje nga znj. Stephenson:

21 Py. Mirëmëngjesi znj. Miftari.

22 Pë. Mirëmëngjesi.

23 Py. Ju lutem, a mund të konfirmoni emrin e plotë dhe
24 datëlindjen?

25 Pë. Jam Taibe Miftari, e lindur më 12.05.1990.

1 Py. Faleminderit.

2 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Zonja Sekretare, a mund t'ju
3 kërkoj ju lutem që të na shfaqni në ekran versionin në gjuhën
4 angleze dhe në gjuhën shqipe të deklaratës. Dhe që është prova
5 materiale me numër DHG0226 deri në DHG0231 dhe versioni në
6 anglisht që mban numrin e referencës DHG0159 [sipas
7 përkthimit] deri në DHG0164 [sipas përkthimit] për versionin e
8 gjuhës tjetër. Faleminderit. Pra të dyja versionet ju lutem
9 shfaqini në ekran.

10 Py. Znj. Miftari, besoj që keni kopje të deklaratës që keni
11 dhënë në shqip. Ju lutem, a mund të lexoni faqen e fundit të
12 deklaratës, shiheni faqen e fundit të deklaratës. A mund të
13 shihni që kjo deklaratë ka 40 paragrafë?

14 Pë. Po.

15 Py. Dhe deklarata mban datën 6 shtator 2021, është kështu?

16 Pë. Po.

17 Py. A mund të vëreni nënshkrimin tuaj në faqen e fundit të
18 deklaratës të dhënë?

19 Pë. Po.

20 Py. A mund të konfirmoni që e keni lexuar deklaratën e dhënë,
21 kohët e fundit?

22 Pë. Po.

23 Py. A mund të konfirmoni gjithashtu ju lutem, që deklarata
24 reflekton me saktësi provën tuaj dhe që ju do të thoni
25 ekzaktesisht të njëjtën gjë në qoftë se do të pyeteshit nga

1 Mbrojtja lidhur me këtë?

2 Atëherë ta bëjmë me faza. E para, a mund të na thoni, të na
3 vërtetoni që deklarata reflekton në mënyrë të saktë pozicionin
4 tuaj, dëshminë tuaj?

5 Pë. Po.

6 Py. Në qoftë se do t'ju bënim pyetje lidhur me ngjarjet që
7 kanë ndodhur në vitin 2020, a do të na përgjigjeshit në të
8 njëjtën mënyrë siç keni dhënë parashtrimet, në deklaratën e
9 dhënë?

10 Pë. Po.

11 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Ne duam që deklarata të pranohet,
12 pra kërkojmë që deklarata të pranohet.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E di që ZPS-ja
14 kundërshton dy paragrafë. Z. Pace, ju lutem mund të na thoni
15 për procesverbal se cilat janë arsyet tuaja për kundërshtimin
16 e këtyre dy paragrafëve?

17 Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, është e saktë. Dy
18 paragrafët që neve kundërshtojmë, është paragrafi 35 që është
19 i gjithë paragrafi me përjashtim të dy fjalive dhe gjithashtu
20 kundërshtojmë pranueshmërinë e paragrafit 40.

21 Arsyet për këtë kanë të bëjnë me përmbajtjen e këtyre dy
22 segmenteve, këtyre dy fragmenteve dhe akuzat të cilat janë të
23 ngritura kundër të akuzuarit. Dhe siç është parashtruar në --
24 sipas parashikimit të rregullit 154, nuk është e nevojshme që
25 të jepen këto dy pjesë. Dhe sipas parashtrimeve përkatëse

1 është e mundur që deklarata të pranohet pjesërisht.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

3 Stephenson?

4 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Ne nuk e pranojmë që këto

5 paragrafë nuk kanë lidhje, nuk janë me rëndësi për çështjen,

6 megjithatë, nuk kemi kundërshtime që të mos i lexojmë këto dy

7 paragrafë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Worboys.

9 Z. WORBOYS: I nderuar Gjykatës, edhe ne kemi të njëjtin
10 pozicion.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 Z. PACE: Të nderuar Gjykatës, ju kërkoj ndjesë për
13 shqetësimin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, mund te
15 vazhdoni.

16 Z. PACE: Në mënyrë që të jemi në të njëjtën linjë,
17 kundërshtimi është me pranueshmërinë edhe sa i takon leximit
18 të këtyre dy paragrafëve të cituar prej meje pak më parë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull, e
20 kuptuam.

21 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Neve e pranojmë
23 kundërshtimin e Prokurorisë. Këto dy paragrafë nuk do të
24 lexohen dhe nuk do të merren parasysh si prova për këtë
25 çështje. Këto pjesë që u cituan nga Prokuroria, pra.

1 Ju lutem mund ta lexoni deklaratën.

2 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Faleminderit.

3 Py. Znj. Miftari, do të bëj një përmbledhje të deklaratës dhe
4 më pas ZPS-ja mund t'ju bëj disa pyetje.

5 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Jam lindur në fshatin Majac në
6 Podujevë, një qytet në Komunë në rajonin e Prishtinës së
7 Kosovës.

8 Pasi e kam kryer shkollën në 2009, kam filluar të punoj në
9 zyrat e Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të
10 Kosovës, OVL UÇK, kur i kisha 19 vjet. Punoj si asistente
11 teknike dhe jam recepsioniste në zyrën kryesore. Nuk ka pasur
12 konkurs për vend të lirë pune. Kam marr vesh për pozitën
13 përmes një të afërmi tim, i cili më vuri në kontakt me Faton
14 Klinakun. Pastaj ai ma ka ofruar punën.

15 Më kujtohet kur janë sjellë dokumentet për herë të parë. Ishte
16 7 shtator 2020, rreth orës 10:00. Isha në zyrën time në katin
17 e katërt, ku gjenden të gjitha zonat kryesore të OVL-së. Në
18 zyrën time ishte edhe një pastruese.

19 E pashë një njeri të panjohur në korridor, pasi dera e zyrës
20 sime ishte e hapur. Njeriu mbante maskë, kapele të bejsbollit,
21 syze të diellit dhe dorëza. Prandaj ishte e pamundur të
22 dalloje ndonjë tipar identifikues.

23 Isha ulur pranë tavolinës sime në zyrë dhe e pashë duke ardhur
24 në korridor. Kur hyri në zyrat tona, në dorë e mbante një
25 paketë. Në fillim u përpoq ta linte paketën mbi një tavolinë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 9

1 por pastaj e ndërroi mendimin dhe hyri në zyrën time. E lëshoi
2 paketën në një tavolinë të vogël drejt tavolinës time. Ishte
3 një paketë prej kartoni e cila ishte goxha e madhe. Isha e
4 ulur në tavolinën time kur e lëshoi paketën dhe tha, "Jepja
5 atij që flet në televizor". E pyeta kush ishte por nuk tha
6 asgjë dhe u largua. U ngrita nga karrigia ime dhe e pyeta disa
7 herë kush ishte, por ai vazhdoi të ecte.
8 Njeriu foli në shqip dhe nuk kishte asgjë të pazakontë apo të
9 çuditshme lidhur me mënyrën se si ai foli. Nuk i kam kushtuar
10 vëmendje njeriut që po largohej dhe nuk kam bërë ndonjë
11 përpjekje për ta ndjekur pas. Isha e brengosur që në paketë
12 mund të kishte bombë dhe isha e frikësuar që do të
13 eksplodonte.
14 Pastaj menjëherë shkova në zyrën e kryetarit Hysni Gucati. Në
15 zyrë ishin Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Faton Klinaku dhe
16 Çelë Gashi. Trokita në derë dhe iu drejtova të gjithëve.
17 Thashë, dikush sapo kishte ardhur në zyrë edhe e kishte lënë
18 një paketë dhe kishte thënë, edhe citohet këtu, "Jepja atij që
19 flet në televizor".
20 Ata pyetën se kush e kishte sjell paketën dhe unë ju thashë që
21 ishte një person i maskuar, maskë mjekësore të Covid-19,
22 mbante kapele bejsbolli, dorëza të bardha medicinale dhe syze
23 të diellit. Rrobat i kishte krejt me ngjyrë të mbylltë dhe në
24 pjesën e poshtme kishte të veshur trejnerka. Ishte e pamundur
25 t'i shihje tiparet e fytyrës, ishte me gjatësi mesatare por

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 10

1 nuk mund të dalloj as moshën dhe as përkatësinë e tij etnike.
2 Ai foli shqip pa ndonjë theks.
3 Të katërt ata erdhën në zyrën time për të shikuar xhirimin e
4 kamerave CCTV. Monitorimi i kamerave ishte në zyrën time.
5 Monitori i kamerave ishte përpara zyrës time. Para se të
6 shikonte çfarë kishte në paketë, ata donin të shihnin kamerën.
7 Në fillimin e kamerave, të gjithë ne e pamë njeriun që e
8 kishte sjell paketën.
9 Kërkova që dikush ta kontrollonte paketën sepse në të mund të
10 kishte bombë. Njeri prej burrave e kapi paketën dhe e largoi
11 nga zyra ime. Katër burrat dolën nga zyra ime por unë qëndrova
12 në zyrë, nuk e di se kush e ka hapur paketën.
13 Ata i vazhduan aktivitetet në zyrën e Hysniut dhe nuk kam parë
14 asgjë.
15 Isha vërtetë e frikësuar dhe e stresuar në atë kohë, meqë
16 asgjë e tillë nuk më kishte ndodhur më parë. Isha e shtangur
17 në të vërtetë, sepse mendova që në paketë kishte bombë dhe për
18 këtë arsye nuk kam dashur ta hap atë. Prej ndodhjes e kam
19 përjetuar pasojat e kësaj tronditjeje. Duke qenë kështu, iu
20 shmangem situatave ku mund të mbetem vetëm në zyrat e OVL-së.
21 Nuk kam qenë e përfshirë fare në konferencën për shtyp e cila
22 është mbajtur. Po ashtu më duhet të them që dokumentet i kam
23 parë vetëm nga distanca dhe nuk më kanë lejuar t'i shoh ato.
24 Të nesërmen, më 8 shtator 2020, përfaqësuesit e Zyrës së
25 Prokurorisë së Specializuar, ZPS, i vizituan zyrat e OVL-së.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 11

1 Ishte koha e drekës dhe të gjithë ne ishim në restorant, i
2 cili gjendet në anën tjetër në të njëjtën kat ku gjenden edhe
3 zyrat. E mbylla zyrën dhe kisha ndërmend t'u bashkohesha të
4 tjerëve.

5 Në krye të shkallëve takova hetuesit e ZPS, të cilët e kërkuan
6 dikë nga organizata, që ishte përgjegjës. U thashë atyre që
7 Faton Klinaku ishte i pranishëm në zyrë. Edhe Hysniu dhe
8 Nasimi ishin me pushime në atë kohë, kështu që Fatoni ishte
9 personi me pozitë më të lartë, i pranishëm.

10 Ata m'i treguan kartelat identifikuese në të cilat thuhej se
11 ishin nga ZPS-ja. I pyeta nëse kishin caktuar takim. Ata thanë
12 që nuk kishin caktuar takim dhe unë i thashë që do të flisja
13 me Fatonin. I thashë Fatonit që kishin ardhur njerëz nga ZPS-
14 ja për ta takuar atë. Pastaj i çova ata njerëz në restorant.
15 Edhe unë u ula për të ngrënë drekë deri sa ata folën për
16 për afërsisht 15 minuta. Nuk isha pjesë e bisedës së tyre.

17 Pastaj e hapa derën e zyrës dhe Fatoni foli me hetuesit e ZPS-
18 së. Prej atëherë e tutje nuk kam qenë më e përfshirë.

19 Më 16 shtator 2020, rreth orës 15:00, u soll dhe një dërgesë
20 tjetër. Në atë çast isha në zyrën time. Isha me Çelë Gashin
21 dhe Elvir Gucatin.

22 Njeriu i panjohur erdhi në zyra duke i mbajtur tri paketa.

23 Njëra ishte më e madhe se sa dy të tjerat. Ai hyri drejt

24 brenda dhe i lëshoi paketat në tavolinën e vogël para

25 tavolinës time. Ai nuk tha asgjë. Vetëm e shikova atë kur i

1 lëshoi paketat në tavolinë dhe nuk më kujtohet t'i kem thënë
2 ndonjë gjë atij.

3 Në kohën e sjelljes së dokumenteve, Hysni Gucati, Nasim
4 Haradinaj, Faton Klinaku dhe Faik Fazlliu ishin të gjithë në
5 zyrën e Hysniut. Pasi që e solli paketën, njeriu shkoi tek
6 ashensori por dukej që kishte telashe në ngjitjen e shkallëve.
7 Ai nuk e shtypi sustën e ashensorit. Dukej sikur kishte shkuar
8 në restorant edhe nuk ishte larguar menjëherë, sa më kujtohet.
9 Shkova dhe i tregova njerëzve çfarë kishte ndodhur në zyrën e
10 Hysniut dhe ata të katërt dolën menjëherë nga zyra. Fatoni
11 vrapoi pas njeriut që i solli dokumentet, por nuk e di se sa e
12 ka ndjekur atë, me që qëndrova në zyrë. Kur u kthye Fatoni,
13 tregoi që njeriu që i solli dokumentet e kishte vënë dorën në
14 brez sikur të kishte armë.

15 Njeriu që i solli ato paketat, ishte ndryshe nga ai që i
16 kishte sjell dokumentet herën e parë më 7 shtator 2020. Ky
17 njeri kishte kapelë të bejsbollit, syze të diellit, doreza,
18 bluze me kapuç dhe rroba me ngjyrë të kaltërt të mbyllët ose
19 të kaltërt të thellë. Ai ishte më i gjatë se njeriu i parë që
20 i kishte sjellë dokumentet. Gjatësia e tij ishte e vetmja gjë
21 që e dallonte atë nga njeriu i parë që kishte sjellë dërgesën.
22 Paketat pastaj i morën Hysniu, Nasimi, Fatoni dhe Faiku dhe i
23 çuan në zyrën e Hysniut. Unë nuk e kam parë kurrë se çfarë
24 kishte në paketa.

25 Unë nuk e kam organizuar konferencën për shtyp, por ju kam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 13

1 treguar disa gazetarëve ku gjendej salla e konferencave në
2 katin e dytë. Nuk e di se sa ishin saktësisht, por përfshirë
3 kameramanët ishin shumë gazetarë pjesëmarrës.
4 Edhe dërgesa e dytë më la të shqetësuar dhe të frikësuar. Nuk
5 e dija se çfarë kishte në paketa. Përsëri kishte mundësi që të
6 kishte një bombë. Jam femër dhe nuk mund të bëja asgjë. Ajo që
7 tha Fatoni që njeriu që e solli dërgesën mund të kishte pasur
8 armë, ma shtoi stresin dhe më tepër. Madje, edhe tani
9 frikësohem të qëndroj vetëm në zyrë.
10 Pas dërgesës së parë, pjesëtarët e lartë të organizatës morën
11 vendimin që nëse kishte dërgesa të tjera, nuk duhet të bënim
12 asgjë. Këtë vendim e mori kryesia e organizatës e cila
13 përbëhet nga 23 pjesëtarë të lartë të OVL UÇK, përfshirë
14 Hysniun, Nasimin dhe Fatonin.
15 Më 17 shtator 2020, hetuesit e ZPS-së arritën në zyra. Ata
16 mbanin kapele, por nuk mbanin syze të diellit. Isha në punë
17 kur erdhën ata dhe nuk më kujtohet se sa persona ishin. Ata
18 vetëm hynë brenda dhe bënë me kokë. Dukej se e dinin se ku
19 donin të shkonin. I çova ata në zyrën e Hysniut dhe ata u
20 morën me Hysniun aty. Dhe unë u ktheva në tavolinën time në
21 zyrën time.
22 Më 22 shtator 2020, rreth afër orës 10:00 erdhi dërgesa e
23 tretë. Isha në zyrën time. Në atë kohë një ushtar aktiv i
24 Forcës së Sigurisë së Kosovës ishte në zyrën time. Ai kishte
25 ardhur për të marrë kartelën e tij të anëtarësisë.

1 E pashë një njeri duke dalë nga ashensori. Ai ishte i maskuar
2 dhe mbante syze të diellit, dorëza dhe një kapele të
3 bejsbollit.

4 Njeriu i vuri duart në bel. Kur e pashë duke bërë atë, isha e
5 ulur pranë tavolinës time dhe lëviza karrigen, që është
6 karrige e zyrës me rrota, sepse nuk e dija se çfarë kishte në
7 brez. Nëse kishte armë ai mund të më vriste. Isha e frikësuar
8 dhe lëviza në të djathë në rast se do të kishte armë.

9 Njeriu kishte grumbuj të dokumenteve në trup të futura nën
10 këmishën e tij. Ai po e ngrinte këmishën lart për t'i nxjerr
11 letrat dhe atëherë mendova që ai ishte duke nxjerrë një armë.
12 Ai pastaj nxori letrat dhe i lëshoi ato në dysHEME. Në këtë
13 moment unë u çova dhe shkova tek dera e zyrës time. I thashë,
14 "Kush je, kush je ti". Atëherë ai bërtiti dhe me zë të lartë,
15 "Mos më pengo, mos më pengo". Pasi e tha këtë gjë, u largua
16 menjëherë dhe shkoi poshtë.

17 Hysniu dhe Fatoni pastaj erdhën nga zyrat e tyre. Nasimi ishte
18 në një takim me përfaqësues të KFOR-it gjerman në atë çast.
19 Mendoj që në atë takim ishin dy prej tyre dhe një përkthyes.
20 Njeriu i cili solli gjërat ishte tjetër njeri prej dy njerëzve
21 të mëparshëm. Ai nuk ishte aq i gjatë sa njeriu i cili solli
22 dërgesën e mëparshme. Përsëri ky njeri mbante syze të diellit,
23 një kapele të bejsbollit, një maskë, dorëza dhe rroba me
24 ngjyrë të mbyllur. Kur bërtiti, e bëri këtë në gjuhën shqipe
25 dhe nuk foli me theks. Nuk munda të dalloj ndonjë tipar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 15

1 identifikues, madje as ngjyrën e lëkurës. Prandaj nuk do ta
2 njihja atë njeri përsëri.

3 Më 25 shtator 2022, erdhi ZPS-ja në zyrat e OVL-së për të
4 bastisur. Isha në zyrën time kur forcat e armatosura hynë në
5 zyrë.

6 Një koleg më tha që një zyrtar i ZPS-së kishte thënë që kisha
7 5 minuta për t'u larguar dhe që duhet të mblidhja gjërat e
8 mia. Ata kryesisht ishin të përqendruar në bastisjen e zyrave.

9 Një zyrtar i ZPS më pyeti se ku ishte Nasimi dhe unë i thashë
10 që nuk ishte në zyrë.

11 Krejt incidenti ishte shumë stresues dhe më ka shkaktuar shumë
12 ankth dhe nuk kam mundur të fle mirë atë natë.

13 Në asnjë moment kurrë nuk më kanë kërkuar të bëj kopje ose të
14 shpërndaj kopje të një dokumenti që ishte sjellë. Vetëm më
15 kanë kërkuar t'i mbart ato prej një zyre në tjetrën, por nuk e
16 kam lexuar asnjëherë prej tyre dhe nuk e di se çfarë përmbanin
17 ato.

18 Në këto rrethana, unë ende shkoj në punë. Por meqë i kam parë
19 personat e maskuar duke hyrë në zyrat OVL-së, brengosem kur
20 shoh njerëzit në publik duke mbajtur maska, meqë ato mbarten
21 aktualisht për shkak të pandemisë Covid-19. Prirem t'u
22 shmangem njerëzve të maskuar. E tërë kjo më ka shkaktuar
23 traumë dhe vërtetë ishte mjaft frikësuese. Nuk ishte e lehtë
24 për mua t'i përjetoje këto incidente.

25 Ky është fundi i përmbledhjes së deklaratës të nderuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 16

1 Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Kjo deklaratë nga Trupi Gjygues do të pranohet në provat,
4 sipas rregullit 154, me përjashtim të një pjese të paragrafit
5 35 dhe paragrafit 40.

6 Trupi Gjygues vëren se pjesa tjetër e deklaratës ka lidhje me
7 çështjen dhe ka vlerë provuese. Përmbajtja e pjesëve të
8 diskutuara në pjesën 35 dhe 40, nuk ka lidhje.

9 Znj. Miftari është e pranishme në sallë dhe është e
10 disponueshme për kundërpjetjet nga Prokuroria dhe pyetje nga
11 Trupi Gjygues. Gjithashtu ajo ka vërtetuar se deklarata me
12 shkrim, në mënyrë të saktë, pasqyron dëshminë e saj.

13 Trupi Gjygues e pranon këtë deklaratë duke i dhënë klasifikim
14 publik.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 deklarata e Dëshmitarit merr numër prove 1D4.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka Mbrojtja e
18 z. Haradinaj ndonjë pyetje për Dëshmitaren?

19 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kundër pyetje
21 nga Prokuroria, nëse ka?

22 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

23 Pyetje të palës tjetër nga Z. Pace:

24 Py. Mirëdita zonja dëshmitare. Më quajnë Xhejms Paç, do t'ju
25 bëj disa pyetje në emër të Prokurorisë, të Zyrës së Prokurorit

1 të Specializuar.

2 Ju nuk e dinit që dokumentet do të silleshin në zyrat e
3 OVL UÇK më datë 7, 16 dhe 22 shtator, kështu?

4 Pë. Jo, nuk e dija.

5 Py. Në fakt ju patët frikë, kujtuat se një person apo disa
6 persona të pidentifikuar, mund të kishin sjellë një bombë në
7 zyra, kështu?

8 Pë. Po.

9 Py. E vetmja gjë që tha personi i pidentifikuar më datë 7
10 shtator në gjuhën shqipe, dhe po e citoj nga deklarata e juaj,
11 "jepja këtë atij që flet në televizor", kështu?

12 Pë. "Jepja atij që flet në televizor". Kështu tha.

13 Py. Pastaj e pyetët se kush është, por ai nuk tha gjë dhe
14 pastaj ai u largua, kështu?

15 Pë. Po.

16 Py. Me aq sa keni ju dijeni, personi atë ditë më datë 7
17 shtator, nuk foli me askënd tjetër në zyrat e OVL UÇK, kështu?

18 Pë. Me aq sa kam dijeni, jo, nuk ka folur me kurrkënd.

19 Py. Pra nuk keni dijeni që ky person atë ditë, më datë 7, të
20 ketë folur drejtpërdrejtë me zoti Hysni Gucati apo Nasim
21 Haradinaj, kështu?

22 Pë. Jo, nuk kam dijeni.

23 Py. Nuk keni dijeni që ky person atë ditë ta ketë parë madje
24 Hysni Gucatin apo Nasim Haradinaj, kështu?

25 Pë. Jo, nuk ka mundësi. Nuk kam dijeni.

1 Py. Dhe me aq sa keni ju dijeni, zoti Gucati dhe zoti

2 Haradinaj vetë nuk e panë atë njeri atë ditë, kështu?

3 Pë. Jo, nuk e kanë parë. Përveç kamerave që i kemi në zyra,
4 d.m.th. përmes xhirimeve që janë në kamera.

5 Py. Duke iu kthyer tani datës 16 shtator. Personi i
6 paidentifikuar nuk tha asgjë kur e lëshoi kutinë në zyrën
7 tuaj, nuk ju kujtohet të ketë thënë që -- edhe ju t'i keni
8 thënë atij ndonjë gjë, kështu?

9 PËRKTHYESI: Flisni më afër mikrofonit, ju lutem.

10 Pë. Jo, nuk më kujtohet që më ka thënë diçka. Nuk e mbaj
11 mend.

12 Z. PACE: [Përkthim]

13 Py. Dhe me aq sa keni dijeni, nuk ka folur me askënd tjetër
14 në zyra atë ditë, kështu?

15 Pë. Sa më kujtohet mua, jo.

16 Py. Nuk keni asnjë dijeni që ai ta ketë parë Hysni Gucatin
17 apo Nasim Haradinajn atë ditë më datë 16 shtator, kështu?

18 Pë. Jo. S'e ka pa as Hysniu, as Nasimi. Përveç xhirimeve të
19 kamerave që janë mbas.

20 Py. Të kalojmë tani tek data 22 shtator. Kur e patë personin
21 e paidentifikuar me dokumentet, siç e thatë dhe po citoj nga
22 deklarata juaj, "Kush je, kush je" i thatë, apo jo?

23 Pë. Po.

24 Py. Personi i paidentifikuar atëherë tha, bërtiti me zë të
25 lartë, po citoj këtu nga deklarata, "Mos më pengo, mos më

1 pengo" dhe pastaj iku menjëherë, kështu?

2 Pë. Aq sa e mbaj mend unë, mënyrën se qysh më ka bërtit, më
3 ka tremb. E mbaj mend vetëm këto dy fjalë që më ka thënë, "Mos
4 më pengo, mos më pengo".

5 Py. Pra nuk ju kujtohet që të ketë thënë ndonjë gjë tjetër?
6 Më datë 22 shtator e kam fjalën.

7 Pë. Jo, mua nuk më kujtohet.

8 Py. Dhe atë ditë më 22 shtator, me sa ju kujtohet, ai nuk
9 foli me njeri tjetër nga zyrat tuaja, kështu?

10 Pë. Ai ka ndej në korridor. Nuk ka hy as në zyra d.m.th. në
11 korridor u pamë, por ka fol me zë shumë të lartë, sa që e kanë
12 dëgjuar edhe të tjerë çka kanë qenë prezent në zyra.

13 Py. Dhe kur foli me zë të lartë, e vetmja gjë që tha është
14 ajo që na e thatë pak më përpara, "Mos më pengo, mos më
15 pengo"?

16 Pë. Me aq sa e mbaj mend unë, është q'ajo, "Mos më pengo, mos
17 më pengo".

18 Py. Zonja dëshmitare, në deklaratën tuaj nuk përmendet
19 konferenca e tretë për shtyp. Mund të na thoni se ku
20 ndodheshit ju kur u zhvillua konferenca e tretë për shtyp?
21 Bëhet fjalë për konferencën e datës 22 shtator 2020.

22 Pë. Kam qenë në zyrë, në punë. Në orar të punës.

23 Py. Do të thotë që ishit e pranishme kur u zhvillua
24 konferenca e tretë për shtyp? E kam fjalën e pranishme në zyra
25 në përgjithësi, më datë 22 shtator 2020.

1 Pë. Në zyra, po. E pranishme në konferencë, jo.

2 Py. Keni luajtur ju vetë ndonjë rol në organizimin apo në
3 marrjen e masave logjistike për konferencën për shtyp? Për
4 këtë konferencë për shtyp për të cilën po flasim?

5 Pë. Për konferencën e tretë? Nuk kam të bëj asgjë me
6 konferencat. Jam punëtore teknike.

7 Z. PACE: [Përkthim] Dëshirojmë t'i tregojmë dëshmitares
8 njëri prej provave tona. Është në listën e provave të
9 Prokurorisë. Nuk ka numër P se nuk është pranuar, ka numër
10 SPOE00314460 deri në 00314460, së bashku me përkthimin në
11 gjuhën angleze.

12 Faleminderit zonja Sekretare.

13 Py. Zonja dëshmitare, a mund ta shihni. Në anën e majtë të
14 ekranit shohim tre fotografi. Ju kërkohet të përqendrohni tek
15 fotografia më e madhe që është në pjesën e sipërme.

16 E keni parë këtë fotografi më përpara, zonja dëshmitare?

17 Pë. Po.

18 Py. Ku e keni parë këtë foto?

19 Pë. Është foto që e ka bërë publike ushtruesi i detyrës të
20 kryetarit tashti, Faton Klinaku, në momentin që neve na kanë
21 përcjellë për këtu, me dhanë dëshmi.

22 Py. A është e saktë se në këtë fotografi, tek kjo që është më
23 e madhja, fotografia më e madhe nga të treja, që është sipër,
24 ju vetë jeni personi i parë djathtas, në të djathtë?

25 Pë. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Page 21

1 Py. Do të kalojmë tani nga ju, tek personi që keni ngjitur,
2 përbri. Mund të na thoni kush është ai person?

3 Pë. Po besoj që jemi në publik. A ka nevojë me përmend emra?
4 Se zakonisht këtu hyn në seanca private, a me vazhdu kështu.

5 Py. Faleminderit për pyetjen.

6 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, e keni ju
7 fjalën. Me sa di unë, ky person nuk e ka problem që t'i
8 përmend emrat publikisht, por nuk dua që të them.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
10 Stephenson, ka ndonjë problem?

11 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] S'ka problem.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Worboys?

13 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofon Gjykatësi.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
15 dëshmitare, mund ta thoni emrin.

16 Pë. Është Elmedina Ballazhi.

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 Py. Dhe ngjitur me znj. Ballazhi, kush është, kush ndodhet?

19 Pë. Metush Kryeziu.

20 Py. Dhe menjëherë ngjitur me z. Kryeziu, cili ndodhet?

21 Pë. Faton Klinaku.

22 Py. Ngjitur me zotin Klinaku, në anën tjetër sigurisht, cili
23 ndodhet?

24 Pë. Pren Marashi.

25 Py. Dhe anash Pren Marashit, jo zoti Klinaku por tjetri, në

1 anën tjetër, cili është ai?

2 Pë. Çelë Gashi.

3 Py. Dhe kush është personi i fundit majtas fotos?

4 Pë. Emin Lati.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Pace, a mund

6 të identifikoni dhe datën e kësaj fotografie?

7 Z. PACE: [Përkthim] Patjetër, i nderuari Gjykatës.

8 Py. Zonja dëshmitare, tani që e shoh provën këtu thotë, 4

9 dhjetor 11:55 a.m., lokacioni Tirana, Shqipëri, Albania. A

10 mund të na konfirmoni se kur ka qenë data dhe pak a shumë ora

11 kur është nxjerrë kjo fotografi, kur është marrë fotografia,

12 kur është bërë?

13 Pë. Data ka qenë 4 dhjetor, d.m.th. ditën që kemi udhëtu për

14 në Hagë.

15 Py. Edhe një pyetje tjetër për këtë. A mund të na thoni pse

16 është bërë kjo fotografia?

17 Pë. Unë në murin tim në Facebook nuk e kam postu edhe nuk e

18 kam pranë tag-ën. Nuk e kam. Qëllimet pse e ka postu Faton

19 Klinaku, unë nuk mund me e dit unë.

20 Py. Faleminderit zonja dëshmitare.

21 Z. PACE: [Përkthim] Unë nuk kam pyetje të tjera për

22 dëshmitaren. Kërkoj që të pranohet në provat materiale ky

23 material së bashku me përkthimin.

24 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

25 Z. WORBOYSË: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 23

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] I lutem

2 Sekretares që t'i caktojë një numër.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të marrë

4 numrin P162.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Duke qenë se

6 nuk ka kundërshtime për P162, pranohet në provë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Stephenson.

9 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, z.

10 Haradinaj ka kërkuar që të bëjë 2 pyetje përkatëse. Nuk dalin

11 me doemos nga pyetjet që ka bërë Prokuroria, por me lejen e

12 Gjykatësve do doja që t'i bëja këto pyetje tani.

13 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofoni Gjykatësi.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në lidhje me

15 çfarë? Ka lidhje?

16 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Na e thoni me

18 çfarë ka lidhje.

19 Z. WORBOYS: [Përkthim] Lidhur me atë çka ka thënë personi me

20 maskë në lëshimin e dokumenteve të dyta.

21 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk shikojmë ndonjë arsye pse duhet të

22 bëhen tani këto pyetje. Duhet të ishin bërë pasi të

23 përfundonte bërjen e pyetjeve zonja Stephenson, përpara se të

24 bëja unë pyetjet. Nuk e kuptoj përse.

25 Avokati mund të ishte konsultuar me klientin e tij dhe t'i

1 kishte bërë këto pyetje përpara.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E rrëzoj
3 kundërshtimin tuaj. Mund ta bëni pyetjen.

4 Z. WORBOYS: [Përkthim]

5 Pyetje të palës tjetër nga z. Worboys:

6 Py. Zonja dëshmitare, mund t'ju bëj dy pyetje? E para është
7 kjo: Kur individi i solli dokumentet herën e dytë, a tha ai
8 gjë se do të sillte edhe dokumente të tjera?

9 Pë. Nuk jam e sigurt. Mund të ketë thanë, mund edhe të mos
10 ketë thanë.

11 Py. Herën e tretë, ai individi a tha gjë që do të sillte CD,
12 kompakt disqe?

13 Pë. Me aq sa më kujtohet mua, nuk e mbaj mend. Nuk e di, për
14 shkak se ka bërtit në mënyrë shumë të keqe, më ka shkaktuar
15 stres edhe nuk po më kujtohet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit z.
17 Worboys.

18 Faleminderit znj. Miftari. Dëshmia juaj ka përfunduar.

19 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja Asistente
21 e sallës, më falni, ju kërkoj ndjesë. Disa prej anëtarëve të
22 Trupit Gjykses dëshirojnë të bëjnë pyetje. Nuk e kuptova.
23 Gjykatësi Barthe, mund të filloni me pyetjet.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi Smith.

25 Pyetje nga Trupi Gjykses:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Worboys

Faqe 25

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Miftari mirëmëngjesi.

2 Shpresoj se më dëgjoni mirë.

3 Pë. Mirëmëngjesi. Po, mirë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kam shumë pak
5 pyetje lidhur me deklaratën e dëshmitarit që ju e keni dhënë
6 dhe të cilën e ka parashtruar Avokati në emër të z. Gucati me
7 numër DHG0159 në shqip dhe DHG0226 në anglisht.

8 Zonja Sekretare.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka një numër që
10 fillon me P.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ka numrin 1D4.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem të vendosni të dyja
14 versionet në ekran. Edhe versionin në shqip, edhe versionin në
15 anglisht.

16 Znj. Miftari.

17 PËRKTHYESI: Një moment.

18 Pë. Ju kisha lut përkthyesit veç pak më ngadalë me fol, se po
19 flet shumë shpejt për me mbajt mend.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Miftari, sipas
21 paragrafit 2 të deklaratës suaj me shkrim, punoni si asistente
22 teknike apo siç e thatë sot si një punonjëse, punëtore
23 teknike, si edhe recepsioniste në zyrën kryesore të OVL UÇK në
24 Prishtinë, kështu është?

25 Py. Po.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni se çfarë
2 bëni me saktësi si asistente teknike apo si punëtore teknike?
3 Pë. Jam në recepsion, i pres palët çka vijjnë, i orientoj ku
4 kanë punë, pranoj kartelat çka vijjnë me u punu. Kartelat e
5 veteranëve domethënë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Miftari, a jeni ju
7 gjithashtu përgjegjëse për faqen kryesore të OVL UÇK?

8 Pë. Jo. E ke faqen për Facebook, faqen e Facebook-ut apo çka?

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, për faqen e Facebook-ut.

10 Pë. Jo, nuk jam unë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Miftari, a jeni ju në
12 dijeni që z. Gucati ka një llogari, profil në Facebook? Jeni
13 në dijeni për këtë?

14 Pë. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si asistente teknike apo si
16 punëtore teknike që punoni për OVL UÇK, a ju lejohet a e keni
17 autorizimin që të vendosni dokumente në llogarinë në Facebook
18 të zotit Gucati, pa autorizimin paraprak të tij? Ju vetë mund
19 ta bëni këtë?

20 Pë. Jo, nuk mundemi ne vetë me përdor Facebook-un e Hysni
21 Gucatit.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në anglisht nuk doli mirë,
23 mund -- nuk mund ta përdorni, do të thotë që nuk ju lejohet,
24 nuk e keni autorizimin apo ka arsye të tjera teknike, pengesa
25 të tjera teknike pse nuk mund ta përdorni llogarinë në

1 Facebook? Pra nuk e dimë, mbase nuk hyni dot në llogarinë në

2 Facebook të z. Gucati?

3 Pë. Llogarinë zoti Gucati e ka mbajtur vetë dhe punëtori tjetër
4 teknik që është aty.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të sqaroni këtë që
6 sapo thatë. Punonjësit e tjerë teknik kanë akses, kanë qasje
7 në llogarinë në Facebook të z. Gucati? Është e saktë kjo?

8 Pë. Më së pari, nuk thashë në shumës 'punonjësit'. Thashë,
9 punëtori tjetër teknik, që është i afërm i kryetarit Hysni
10 Gucati. Ai, me autorizim të Hysni Gucatit, e ka përdorur
11 Facebook-un e tijna.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na tregoni emrin e
13 këtij personit tjetër, të këtij asistenti tjetër teknik që
14 sapo e përmendët?

15 Pë. Është Elvir Gucati.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Miftari, pyetja e
17 dytë. Ka të bëjë me paragrafin 5 të deklaratës tuaj me shkrim.
18 Sot na thatë se njeriu i panjohur, ai që lëshoi dokumentet në
19 tavolinën tuaj tha, dhe po citoj, "Jepja atij që flet në
20 televizor".

21 Zonja Miftari, sipas mendimit tuaj, për cilin person e
22 kishte fjalën ky njeriu i panjohur? Si e kuptove ti këtë
23 fjali?

24 Pë. Nuk mund me e dit për cilin personalisht e ka pas fjalën,
25 sepse kanë fol nëpër media të dy, edhe zoti Hysni Gucati edhe

1 Nasim Haradinaj.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, siç e kuptoni ju, ky
3 person mund të ishte ose zoti Gucati ose zoti Haradinaj,
4 kështu?

5 Pë. Është edhe zoti Faton Klinaku që fol nëpër media. Ka mujt
6 me qenë për Hysniun, ka mujt me qenë për Nasimin, ka mujt me
7 qenë për Fatonin. Nuk mujt me e dit për cilin person e ka pas
8 fjalën.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër
10 ka të bëjë me paragrafin 13 të deklaratës tuaj për shtyp, ku
11 thuhet, dhe po citoj:

12 "Nuk kam qenë e përfshirë fare në konferencën për shtyp e
13 cila është mbajtur. Po ashtu dua të them që dokumentet i kam
14 parë vetëm nga distanca dhe nuk më kanë lejuar t'i shoh ato".

15 Zonja Miftari, a të tha dikush që nuk të lejohet me i pa
16 këto dokumente dhe nëse ta ka thënë dikush, kush ishte ai që
17 ta ka thënë?

18 Pë. Dokumentet janë marrë domethënë -- shefat janë marrë me
19 dokumentet. Neve punëtorëve teknikë nuk na u ka lejuar.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të përcaktoni kush
21 janë shefat?

22 Pë. Është Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Fatoni tash. Edhe
23 atëherë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nëse ju kuptova saktë,
25 nuk është se jua tha dikush që nuk ju lejohet t'i shihni këto

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 29

1 dokumente, kështu? Pra askush prej shefave, as zoti Haradinaj,
2 as zoti Gucati, as zoti Klinaku, apo ndonjë person tjetër t'ju
3 ketë thënë që, nuk ju lejohet t'i shihni dokumentet, kështu?
4 Pë. Në momentin që kanë ardhur dokumentet, kanë shkuar në
5 zyrën e Hysni Gucatit. Në zyrën e Hysni Gucatit nuk kena hy
6 dhe nuk na lejohet me hy në qoftë se s'kemi punë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Miftari, sipas
8 paragrafit 26 të deklaratës tuaj, keni thënë, dhe po citoj:

9 "Pas dërgesës së parë, pjesëtarët e lartë të organizatës
10 morën vendim që nëse -- pra thanë që nuk duhet të bënim asgjë
11 nëse do të kishte dërgesa të tjera. Këtë vendim e mori kryesia
12 e organizatës e cila përbëhet nga 23 pjesëtarët më të lartë të
13 OVL UÇK, përfshirë Hysniun, Nasimin dhe Fatonin".

14 Pyetja ime është kjo zonja Miftari, nga e dini ju që pas
15 dërgesës së parë anëtarët e lartë të organizatës morën vendim
16 të mos bëhej asgjë nëse do të kishte dërgesa të tjera? Jua tha
17 dikush? Dhe nëse jua tha dikush, kush?

18 Pë. Po, na ka thanë Faton Klinaku, që në atë kohë ka qenë
19 sekretar dhe përgjegjës për punëtorët teknik.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra që ta kuptoj unë, Faton
21 Klinaku tha se organizata ose më saktë që kryesia kishte
22 vendosur që të mos bëhej asgjë nëse do të kishte dërgesa të
23 tjera, nëse do të vinin apo do të silleshin dokumente të
24 tjera, kështu?

25 Pë. Në recepsion jam unë, jam femër. Edhe me dash me bo

1 diçka, nuk kisha mujt unë. Por Fatoni më ka thanë, rri e qetë
2 kujdesu për shëndetin tënd edhe mos ndërhy kurrëgjë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Pyetja tjetër ka
4 të bëjë me paragrafin 27 të deklaratës tuaj me shkrim, ku
5 thuhet:

6 "Më 17 shtator 2020, hetuesit e ZPS arritën në zyra".

7 Pra zonja Miftari, kjo ka ndodhur një ditë pas ardhjes
8 për herë të dytë të dokumenteve. A ishte hera e parë që
9 punonjës të ZPS, të Zyrës së Prokurorit të Specializuar erdhën
10 pas sjelljes për herë të dytë të dokumenteve? Apo kanë qenë
11 edhe herë të tjera ZPS-ja në zyrat e OVL UÇK përpara sjelljes
12 për herë të dytë të dokumenteve, pra më datë 16 shtator 2020?
13 Pë. ZPS-ja ka qenë edhe herën e parë kur ka ardhur me i marrë
14 dokumentet më 8 shtator.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pas sjelljes për herë të
16 dytë të dokumenteve më datë 16 shtator, kur erdhën më datë 17
17 apo erdhën që më datë 16?

18 Pë. Me sa më kujtohet mua, kanë ardhur më datë 17. Me sa më
19 kujtohet.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Miftari, pyetja e
21 fundit që kam ka të bëjë me paragrafin 34 të deklaratës tuaj.
22 Më saktë ka të bëjë me fjalinë e tretë ku thoni:

23 "Kur bërtiti ai", pra personi i tretë që i solli
24 dokumente OVL UÇK-së, "e bëri këtë në gjuhën shqipe dhe nuk
25 foli me theks".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Taibe Miftari (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 31

1 Pra a e kam kuptuar mirë zonja Miftari, kjo është pyetja
2 ime, që asnjëri prej tre personave që kanë sjell dokumente më
3 datë 7, datë 16 dhe datë 22 shtator 2020, nuk e flisnin
4 shqipen me theks, kështu është, kështu po dëshmoni këtu?
5 Pë. Po, e kanë fol shqip kanë folur dhe nuk kam mujt me kuptu
6 a është e rëndë a është... Shqip e kam kuptu shumë mirë çka ka
7 thanë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.

9 Miftari. Unë nuk kam më pyetje të tjera.

10 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] A mund t'i bëj unë një pyetje znj.
11 Miftari për të sqaruar diçka?

12 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofoni Gjykatësi.

13 Pyetje vijuese nga znj. Stephenson:

14 Py. Zonja Miftari, kur zoti Klinaku ju tha që të mos bënit
15 asgjë pas dokumenteve të para që ju sollën, a mund të sqaroni
16 me saktësi se çfarë të tha që të mos bënit, pas ardhjes për
17 herë të parë të dokumenteve? Pas ardhjes së dytë, pas
18 dorëzimit.

19 Z. PACE: [Përkthim] Më falni, mbase e kam gabim, por
20 është hera e dytë apo hera e parë. Sepse paragrafi në fjalë
21 bën fjalë për sjelljen për herë të parë të dokumenteve.

22 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Kërkoj ndjese. Faktikisht pas
23 herës së parë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më duket se
25 zonjën Stephenson e ngatërroi bashkëmbrojtësi.

1 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim]

2 Py. Dëshironi t'jua bëj edhe njëherë pyetjen?

3 Pë. Po.

4 Py. Ju i thatë Trupit Gjykues se, Fatoni të tha të mos bëje
5 asgjë pas sjelljes për herë të parë të dokumenteve. A mund të
6 na thoni çfarë tha tamam ai që të mos bëje?

7 Pë. Ai tha, kujdesu për shëndetin tënd edhe rri e qetë. Në
8 qoftë se ndodh me ardh përsëri [e padëgjueshme].

9 Py. Në rregull, faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

11 Faleminderit zonja Stephenson.

12 Në rregull. Zonja Miftari, tani keni përfunduar. Shpresoj
13 t'ia kaloni mirë pjesën tjetër të ditës. Faleminderit që ishit
14 këtu me ne sot.

15 Sekretarja do t'ju nxjerrë, do t'ju shoqërojë nga salla e
16 gjyqit. Faleminderit.

17 DËSHMITARJA: Faleminderit edhe juve.

18 [Dëshmitarja largohet]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më kanë

20 këshilluar që dëshmitari i radhës nuk është këtu akoma, kështu
21 që do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore. Shpresojmë që do të
22 jetë e pranishme pas gjysmë ore.

23 Atëherë kemi pushim deri në orën 11:00. Faleminderit për
24 vëmendjen.

25 --- Pushimi fillon në orën 10.32

1 --- Seanca rifillon në orën 11.00

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Kemi të
3 njëjtët persona të pranishëm në sallë, apo jo, për të gjitha
4 palët?

5 Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi ndryshime, të nderuar
6 Gjykatës.

7 Z. WORBOYS: [Përkthim] Nuk ka ndryshime por dua të nge
8 një çështje në qoftë se mundem.

9 Lidhur me përgatitjen e dëshmitarëve javës që vjen.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Vetëm një
11 sekondë ju lutem.

12 Ju lutem vazhdoni, zoti Worboys.

13 Z. WORBOYS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar
14 Gjykatës. Sa i takon përgatitjes për dëshmitarët për javës që
15 vjen, dua ta përditësoj Gjykatën që ne jemi në procesin e
16 ndërlihdjes me Zyrën e Sigurisë së dëshmitarëve. Shpresoj që
17 do të kemi një informacion më të përditësuar deri është fund
18 të ditës kështu që në qoftë se do të na lejonit dy minuta
19 përpara se ta përfundonim sot, do ju ishim mirënjohës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
21 Faleminderit, zoti Worboys.

22 Jemi gati që të vazhdojmë me dëshmitarin e radhës, që
23 është dëshmitarja 1242. Është deklarata e zonjës Elmedina
24 Ballhazi.

25 Zonja Sekretare, ju lutem shoqërojeni dëshmitaren brenda

1 sallës së gjyqit.

2 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
4 zonja Ballhazi. Sekretarja tani do t'ju japë tekstin e
5 deklaratës solemne që duhet ta lexoni në përputhje me
6 rregullin 141(2) i Rregullores. Ju lutem lexojeni kur keni
7 mundësi, kur të jeni gati.

8 Ju lutem, lexoje me zë.

9 DËSHMITARJA: E ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë
10 sime, dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se
11 do të them të vërtetën, krejt të vërtetën, dhe vetëm të
12 vërtetën, dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam
13 dijeni.

14 DËSHMITARJA: ELMEDINA BALLHAZI

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

16 Faleminderit, zonja Ballhazi, ju lutemi ulini.

17 Zonja Ballhazi, ne do të dëgjojmë sot dëshminë tuaj. Siç
18 mund ta dini, zoti Rees ose zonja Stephenson së pari do t'ju
19 bëjnë pyetje lidhur me deklaratën tuaj. Më pas, ne do të kemi
20 një diskutim të shkurtër lidhur me deklaratën tuaj dhe pasi ta
21 kemi përfunduar këtë diskutim, pjesa e pranuar e deklaratës
22 tuaj do të lexohet këtu.

23 Më pas, ndoshta avokati mbrojtës mund t'ju bëjë disa
24 pyetje të tjera, në qoftë se ka. Më pas do ta ketë radhën
25 Avokati që përfaqëson zotin Haradinaj, për të bërë pyetje.

1 Pastaj do t'i vijë radha Prokurorisë dhe edhe anëtarët e
2 Trupit Gjykses mund të kenë në fund disa pyetje për ju.

3 Zoti Rees ose zonja Stephenson parashikojnë që deklarata
4 juaj do t'ju marrë deri në pesëmbëdhjetë minuta. ZPS-ja
5 parashikon që do t'i duhen deri në dy orë për t'ju marrë në
6 pyetje. Mbase nuk do të jetë kaq shumë kohë e nevojshme për
7 ZPS-në dhe ne do të bëjmë pyetjet tona në qoftë se kemi.

8 Ju lutem, mundohuni që t'i përgjigjeni pyetjeve me fjali
9 të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen,
10 ju lutem kërkoni avokates që ta përsërisë edhe një herë
11 pyetjen ose t'i sqarojë pyetjet në qoftë se nuk e kuptoni.
12 Gjithashtu, ju lutem mundohuni që të thoni bazën e njohurisë
13 tuaj të fakteve dhe të rrethanave rreth të cilave do të
14 pyeteni.

15 Ju lutem flisni përpara mikrofonit dhe prisni deri pesë
16 sekonda përpara se të jepni përgjigje pyetjes dhe pastaj
17 flisni në një ritëm të ngadaltë në mënyrë që t'ju ndjekin
18 plotësisht përkthyesit.

19 Ndërkohë që jepni dëshmi përpara kësaj Gjykate, nuk
20 lejoheni që të diskutoni me askënd lidhur me përmbajtjen e
21 deklaratës tuaj. Në qoftë se dikush jashtë Gjykatës ju bën
22 pyetje lidhur me deklaratën tuaj, ju lutem na thoni.

23 Kush do ta marrë dëshmitaren në pyetje nga ekipi i
24 Mbrojtjes?

25 Zonja Stephenson?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 36

1 Siç e thamë edhe më përpara, ne do t'ju bëjmë disa
2 pyetjet lidhur me faktin në qoftë se deklarata juaj reflekton
3 atë çfarë ka ndodhur realisht dhe pastaj do të vendosim sa i
4 takon deklaratës tuaj se cilat pjesë të sajë do të pranohen.

5 Pyetje nga Znj. Stephenson:

6 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim]

7 Py. Mirëmëngjes, zonja Ballhazi. Ju quheni Elmedina Ballhazi
8 dhe jeni lindur më 9 dhjetor 1994. Kështu është?

9 Pë. Po kështu është, dhe sot kam ditëlindjen, që po e festoj
10 para Trupit Gjykues, duke dhënë dëshminë time mbrojtëse ndaj
11 zotit Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucatit. Pra sot i mbushi 27
12 vite.

13 Py. Gëzuar ditëlindjen nga të gjithë ne.

14 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Zonja Sekretare, ju lutem a
15 mund të na shfaqni në ekran versionin e deklaratës në gjuhën
16 shqipe dhe në gjuhën angleze. Për procesverbal, versioni në
17 anglisht është dokumenti DHG0170 deri në DHG0176. Ndërkohë që
18 versioni në shqip është dokumenti me numrin e identifikimit
19 DHG0139-DHG0143.

20 Py. Zonja Bellhazi, të lutem a mund të shohësh pak faqen e
21 fundit të deklaratës që duhet ta keni përpara. A shihni që kjo
22 deklaratë përmban 34 paragrafë?

23 Pë. Po.

24 Py. Dhe mban datën 4 shtator, 2021. Është kështu?

25 Pë. Këto kanë datën 16 korrik, 2021, të nënshkruar në shqip

1 dhe në anglisht kanë datën 4 shtator 2021.

2 Py. Mirë atëherë, kam përpara në fakt versionin në anglisht.

3 Sa për ta konfirmuar që data në versionin anglisht është 4

4 shtator, 2021. Po nënshkrimi në fund fare, është nënshkrimi

5 juaj?

6 Pë. Po.

7 Py. Faleminderit. Ju lutem, a mund të na konfirmoni që së

8 pari e keni lexuar deklaratën kohët e fundit?

9 Pë. Po.

10 Py. Ju lutem, a na konfirmoni po ashtu që deklarata reflekton

11 me saktësi provat dhe që do të thoni këto gjëra në qoftë se do

12 të pyeteni.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Lidhur me këtë dëshmitar, kuptohet

14 që Mbrojtja e Gucatit do të japë vetëm paragrafë të caktuar të

15 kësaj deklarate. Kështu që do të pyesnim që të ri formulohej

16 edhe një herë pyetja e zonës Stephenson për t'ju reflektuar

17 vetëm këtyre paragrafëve.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Do t'i

19 kthehem kësaj çështjeje.

20 Pra e di që ju keni disa kundërshtime dhe kuptimi im

21 është që ju nuk i kundërshtoni, domethënë Mbrojtja nuk e

22 kundërshton këto kundërshtimet e ZPS-së.

23 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim]

24 Py. Ju lutem a mund të na thoni që deklarata reflekton në

25 mënyrë të saktë provat tuaja dhe që do të jepni këto përgjigje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 38

1 në qoftë se do ju bëhen pyetje lidhur me atë çfarë keni
2 deklaruar.

3 A mund të konfirmoni, ju lutem që përmbajtja e deklaratës
4 suaj është e vërtetë?

5 Pë. Po, e vërtetë.

6 Py. Faleminderit.

7 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne
8 kërkojmë pranimin e deklaratës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Tani mund
10 të thoni se çfarë paragrafësh kundërshtoni.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

12 Ne kundërshtojmë paragrafët nga 15 deri në 26, dhe
13 paragrafët 33 deri në 34, për arsye të cilat i kemi dhënë me
14 email me datë 7 dhjetor, 2021. Ndërkohë që e dimë që nuk ka
15 kundërshtim nga Mbrojtja.

16 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Ne nuk do të pyesim për këto
17 paragrafë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
19 Faleminderit.

20 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Përveç kësaj, domethënë, ne
21 nuk do të përfshijmë as paragrafin një. Nuk do ta lexojmë
22 këtë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem
24 a mund t'i caktoni këtij dokumenti? Një numër këtij dokumenti?

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata është prova

1 materiale me numrin 1D5.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ma thoni
3 edhe një herë, D5? Po.

4 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] 1D5
6 pranohet, me përjashtimet e paragrafëve të cilat i përmendën
7 më përpara, 15-26, 33-34 dhe paragrafi 1 që na tha
8 bashkëmbrojtësja.

9 A keni ndonjë gjë tjetër, zonja Stephenson?

10 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Jo. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
12 Worboys?

13 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo. Për momentin nuk kemi. Nuk
14 propozojmë që të bëjmë ndonjë pyetje sepse paragrafi 1 nuk
15 është pranuar, megjithatë në qoftë se do të kemi ndonjë
16 pyetje, në qoftë se na del ndonjë pyetje, do ju vë në dijeni.
17 Faleminderit.

18 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Sigurisht që ne do të lexojmë
19 përmbledhjen e deklaratës. Do të duam që të lexojmë
20 përmbledhjen e deklaratës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Po, po. E
22 kuptoj këtë.

23 Nuk kemi asgjë tjetër përpara se të lexojmë deklaratën?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mund të

1 vijoni me leximin.

2 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Faleminderit.

3 Py. Ne do të lexojmë përmbledhje të deklaratës. Ju lutem
4 dëgjojeni dhe pastaj ZPS-ja mund të ketë disa pyetje për ju.

5 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Në shtator të vitit 2020
6 punoja në një portal medial të quajtur arbresh.info dhe isha
7 duke realizuar intervista vox po me qytetarë në qendër të
8 Prishtinës, Kosovë. I kemi kryer disa vox pop dhe jemi ndaluar
9 të pushojmë për ët vazhduar me intervista me qytetarë të
10 tjerë.

11 Rreth orës 10.30 deri në 11.00 kemi filluar të marrim vox
12 pop. Më 16 shtator të vitit 2020, diku ndërmjet orës 11.00 dhe
13 12.00 e kam përmendur që e kam parë një veturë të bardhë ose
14 ngjyrë gri afër vendit ku isha ulur te shkallët përballë
15 zyrave të OVL UÇK-së me kameramanin tim, Pajtim Bejtullahu.
16 Dëshiroj të shtoj disa informata të tjera lidhur me këtë
17 veturë.

18 Në atë kohë e dija që kishte diçka të dyshimtë lidhur me
19 veturën. Intuita më thoshte që kishte diçka jo në rregull
20 lidhur me të. Vetura ma tërhoqi shikimin.

21 Mund të shihja që ishin dy persona në automjet. Nuk mund
22 të dalloja tabelën e regjistrimit ose modelin e veturës, por
23 mendoj që mendoj që mund të ketë qenë veturë Dacia ose
24 Renault. Nuk jam e sigurt për modelin por mendoj që do të
25 ishte një model më i vjetër.

1 Vetura ndalej pastaj ecte përpara, pastaj ndalej përsëri,
2 sikur të ishte duke u përpjekur të parkonte. Megjithatë nuk
3 kishte parkim në udhëkryq afër përmendores ku gjendej vetura.
4 Prandaj ma mori mendja që vetura po kurdiste diçka.

5 Vetura po ndalej dhe nisej sikur të mos e dinte se nga po
6 shkonte apo çfarë po bënte. Do të thosha që vetura pra në
7 udhëkryq nuk kishte -- afër përmendores nuk gjendej vetura.
8 Prandaj ma mori mendja që vetura po kurdiste diçka. Vetura po
9 ndalej dhe nisej sikur të mos e dinte se nga po shkonte ose se
10 çfarë po bënte. Do të thosha që vetura po vepronte shumë
11 dyshimtë dhe duke qenë kështu, nuk munda t'i largoja sytë nga
12 ajo.

13 Në fund vetura u ndal vetëm pak është larg zyrave të OVL
14 UÇK-së, por jo shumë afër tyre.

15 I thashë kameramanit tim, Pajtimit, që kjo ishte diçka që
16 duhej ta filmonim. Në fillim ai më tha që unë gjithmonë
17 dyshoja dhe mos po shoh halucinacione, por vazhdova t'i them
18 Pajtimit që ishte intuita ime dhe që e dija që diçka nuk ishte
19 në rregull me këtë veturë.

20 Dritaret e veturës ishin të mbyllura por mund të shihja
21 që si ngasësi ashtu edhe udhëtari po shikonin përreth. Ata nuk
22 i nxirrni kokat jashtë dritares. Ata vetëm shikonin përreth
23 deri sa ishin brenda veturës.

24 Pastaj e pash një person që doli nga vetura që doli nga
25 vetura nga ana e udhëtarit dhe mund të shihja që ishte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 42

1 mashkull. Ai kishte të veshur rroba sportive me ngjyrë të
2 mbyllur, një kapelë të zezë, një maskë të fytyrë dhe dorëza.
3 Ai pastaj mori disa paketa të mëdha nga brenda veturës dhe
4 shkonte anash duke shikuar përreth. Ekziston videoja e
5 xhirimit të këtij njeriu. Ai pastaj eci shpejtë nga vetura në
6 drejtim të zyrave të OVL UÇK-së. Nuk më kujtohet emri i
7 rrugës. Pastaj e pash që ai hyri në zyrat e OVL UÇK-së në anën
8 e djathtë të rrugës, siç mund të shihet në video xhirim.

9 Në këtë çast insistova te kameramani im, Pajtimi, që të
10 fillonte të xhironte personin që po dilte nga vetura. Deri sa
11 ishte duke e bërë këtë bisedë me Pajtimin, për një çast e hoqa
12 vëmendjen nga vetura dhe shoferi brenda veturës. Pasi e kisha
13 parë dërgesën e parë në televizion, supozova që ky ishte mund
14 të ishte një dërgim tjetër i dokumenteve. I thashë Pajtimin:
15 "të lutem fillo të xhirosh. Garantoj që kjo është një dërgesë
16 tjetër". E bëmë këtë bisedë për afërsisht 20-30 sekonda.

17 Gjatë kësaj bisede me Pajtimin e harrova veturën dhe
18 vëmendjen e kisha te pasagjeri. Pajtimi ishte në shkallë dhe
19 unë isha ulur te shkallët, e mbështetur afër tij. Ne kishim
20 pamje të drejtpërdrejtë të zyrave, në kënd të udhëkryqit ku
21 gjendeshin zyrat. Isha duke qëndruar afërsisht 15 metra larg
22 vendit ku ishte vetura e parkuar. Më pas e pash po ashtu
23 personin e njëjtë duke dalë nga zyrat e OVL UÇK-së dhe duke u
24 kthyer në të djathtë, pasi që doli nga zyra. Ai vrapoi shumë
25 shpejtë duke u kthyer në të djathtë dhe në fund të rrugës,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Stephenson

Faqe 43

1 përmes një tuneli dhe në fund nuk e pash më. Nuk jam përpjekur
2 ta ndjek personin. Vëmendjen e veturës e harrova, nuk e di se
3 nga ka shkuar dhe i thashë Pajtimimit që do të shkoj në zyrat e
4 OVL UÇK-së dhe të shoh se ç'mund të marr vesh edhe të përpiqem
5 të marr një deklaratë, meqë isha e sigurt që ishin dorëzuar
6 dokumentet pasi kisha parë pakot në duart e tij. E dija nga
7 dërgesa e parë që e kisha parë në mediat që dokumentet i
8 kishte dorëzuar një person që mbante maskë dhe një kapelë që
9 kjo dukej shumë e ngjashme me atë të herës së parë.

10 Kur u ktheva në zyrë dhe e shikuam video xhirimin, e
11 kuptuam që e kishim kapur personin edhe duke i dorëzuar
12 dokumentet edhe duke u larguar nga zyrat pas lënies së tyre.
13 Atëherë nuk e dija që kjo ishte filmuar nga Pajtimi sepse të
14 dy ishim me stres të atij personi.

15 Rreth përfaqësisht orës 5.00 e botuam, e publikuam video
16 xhirimin në arbresh.info.

17 Pasi punës ika për në shtëpi dhe gjithmonë përcjellja
18 lajmet dhe debatet të shoh që çka po ndodhte.

19 Dua të them që nuk e kam ditur që do të ndodhë sjellja e
20 dokumenteve dhe askush nuk më kishte paralajmëruar
21 paraprakisht. Ka ndodhur që kam qenë afër zyrave të OVL UÇK-së
22 rastësisht. Thjesht kam qenë duke bërë punën time si gazetare
23 dhe jam përpjekur të kuptoj më shumë lidhur me ndonjë situatë
24 sepse vetë kam bërë edhe hulumtime. Por sigurisht që nuk kam
25 pasur ndonjë paralajmërim.

1 Dua të them që as ZPS-ja, as askush tjetër nuk më ka
2 kontaktuar pasi që kam qenë në zyrat e OVL UÇK-së në atë ditë.
3 Nuk më kanë pyetur personalisht dhe askush nga ZPS-ja nuk e ka
4 kontaktuar arbresh.info, median ku kam qenë duke punuar në atë
5 kohë në vitin 2020.

6 Video xhirimi është në Facebook, në YouTube, asgjë nuk
7 është prerë apo edituar nga xhirimi.

8 Ky është fundi i përmbledhjes, të nderuar Gjykatës.

9 A mund t'i kërkoj zonjë Sekretare që të na shfaqë një
10 video. Pra flitet për videon që është dhënë në listën e
11 dokumenteve dhe është dokumenti i identifikuar me numrin
12 DHG0459, ju lutem.

13 [Luhet videoincizimi]

14 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Faleminderit.

15 Py. Zonja Ballhazi, a mund të konfirmoni që kjo është videoja
16 të cilës i referoheni në deklaratën tuaj?

17 Pë. Po, kjo është.

18 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Duam që të edhe kjo video të
19 pranohet si prove materiale, të nderuar Gjykatës.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Rëndësia e videos është skajore,
21 në rastin më të mirë. Megjithatë, ne nuk është se e
22 kundërshtojmë atë për momentin.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem
24 caktojini numrin e provës materiale.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 kjo video merr numrin e provës materiale 1D6.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] 1D6
3 pranohet pa kundërshtim.

4 Ndonjë gjë tjetër më tepër, zonja Stephenson?

5 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Jo.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
7 Worboys?

8 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, përderisa paragrafi 1 nuk u
9 pranua, nuk kemi pyetje të tjera.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Prokuroria?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, zoti Gjykatës.

14 Të vetmen pyetje që ne mund të kishim për këtë dëshmitar
15 janë pyetje të cilat kanë të bëjnë me praninë -- që mund të
16 kishin me praninë e saj brenda OVL së UÇK-së dhe duke pasur
17 parasysh që dëshminë e saj nuk është thënë asgjë asgjekund sa
18 i takon pranisë së saj në OVL-në e UÇK-së në këtë pikë ZPS-ja
19 nuk ka asnjë pyetje për dëshmitaren.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë Gjykatësi
22 Smith, unë kam disa pyetje për ju, zonja Ballhazi, që kanë të
23 bëjnë me deklaratën tuaj dhe pyetja që ka të bëjë me pjesë të
24 caktuara të deklaratës tuaj që u pranuan si provë, duke
25 përfshirë edhe paragrafin 1 të deklaratës tuaj, ku ju thoni

1 që:

2 "Jam intervistuar më parë në cilësinë e dëshmitares në
3 çështjen e Nasim Haradinajt, Kryetari i OVL UÇK-së, nga Toby
4 Cadman, që është avokati i zoti Haradinajt dhe gjithashtu edhe
5 nga Lumnie Ahmeti, përkthyesja".

6 Zonja Ballhazi, a mund të na thoni se çfarë doni të thoni
7 kur thoni jeni intervistuar nga Zoti Cadman? Pra kontakti ka
8 qenë vetëm thjesht me email, ka qenë në telefon. A mund ta
9 shpjegoni pak më tepër këtë pjesë të deklaratës tuaj, ju
10 lutem?

11 Pë. Mënyra e komunikimit ka qenë në WhatsApp, kemi komunikuar
12 dhe jemi takuar.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem, a specifikoni dot
14 edhe një herë pjesën e fundit të përgjigjes tuaj. A e kuptoni
15 se çfarë është deklarata e dëshmitarit? E kuptoni termin
16 "deklaratë e dëshmitarit"?

17 Py. Kjo deklaratë kur më ka ardhur mua, unë e kam përmendur
18 si pikë të parë se jam intervistuar më parë, dhe pastaj është
19 marrë krejt deklarata ime që është këtu.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime ishte kjo: a e
21 kupton ti se çfarë është intervista e dëshmitarit.

22 Z. WORBOYS: [Përkthim] Të nderuar, ju kërkoj ndjesë. A
23 mund të sugjeroj unë për një zgjidhje tjetër për sa i takon
24 shpjegimit të çështjeve faktike.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E dëgjova këtë gjë, e

1 dëgjova edhe komentit tuaj por jam i interesuar se çfarë
2 do të thotë dëshmitarja lidhur me këtë pyetje. Do t'ju
3 kthehem, do t'ju vijë radha edhe juve, por për momentin dua
4 që t'a pyes dëshmitares që të më përgjigjet për pyetjen që
5 sapo bëra.

6 A e kupton se çfarë është "intervista e dëshmitarit"? Pra
7 që dikush të bën pyetje dhe personi tjetër, domethënë
8 dëshmitari i përgjigjet këtyre pyetjeve. Pra ndonjë herë ose
9 pjesën më të madhe të rasteve, ka edhe një raport të
10 protokolluar, ose një transkriptim të protokolluar, si
11 rezultat i intervistës së dëshmitari. E kuptoni këtë gjë?
12 Pë. Unë të thash pak më herët se jam kontaktuar nga avokati
13 Toby Cadman të takohemi dhe të flasim për video xhirimin tim.
14 Ky ka qenë, dhe në këtë deklaratë e kam futur edhe pikën time
15 sepse kjo është nënshkruar në datën 16 korrik, 2021. Është e
16 qartë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, po deklaron që në fakt
18 jeni intervistuar nga zoti Cadman me 16 korrik 2020 dhe që ju
19 keni nënshkruar një dokument atë datë? Këtë po thoni?

20 Pë. Jo, ne jemi takuar në mars të vitit 2021. Dhe këtu në
21 deklaratë e kam futur edhe si pikë se kur jam intervistuar.
22 Vetëm kjo ka qenë. E kam dhënë sqarim.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Ballhazi, a keni
24 nënshkruar ju një dokument në mars të vitit 2021?

25 Pë. Jo.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do t'i kthehemi besoj kësaj
2 çështje edhe pak më vonë.

3 Pyetja tjetër ka të bëjë me paragrafin 4 të deklaratës
4 suaj, zonja Ballhazi, ku thoni, po citoj:

5 "Në atë kohë e dija që kishte diçka të dyshimtë lidhur me
6 veturën".

7 Me aq sa mbani mend, nga këndvështrimi juaj, a mund të
8 thoni se çfarë kishte të dyshimtë lidhur me veturën?

9 Pë. Pasi që dosjet janë sjellë në Rrufenë 1, siç është
10 quajtur në media, atëherë intuita më ka thënë se kjo është një
11 dërgesë tjetër.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo ishte -- domethënë kjo
13 të erdhi në mendje në momentin e parë që e pe makinën?

14 Pë. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ti e pe veturën dhe
16 gjëja e parë që të erdhi në mendje ishte që kjo mund të ishte
17 një dërgesë tjetër. Është e saktë kjo?

18 Pë. Aty i pashë dy persona dhe sa ndalej vetura, sa ecte. Sa
19 ndalej, sa ecte. Vetëm ma ka tërheqë shikimin dhe kam vazhduar
20 ta shikoj.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra ishte për shkak të
22 mënyrës se si vetura apo shoferi i veturës e ngiste veturën që
23 të shtyu të kishe dyshime. Kështu?

24 Pë. Nga lëvizja e asaj veture vetëm kam vazhduar ta shikoj.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe sipas paragrafit 11 të

1 deklaratës suaj, e kam fjalën për fjalinë e tretë -- jo më
2 falni, fjalinë e katërt, që thotë kështu, po citoj:

3 "I thashë Pajtimit" kameramanit tuaj, "të lutem fillo të
4 xhirosh. Garantoj që kjo është" pra ishte, "një dërgesë
5 tjetër"". Mbyllet citimi këtu.

6 Ka qenë ky momenti kur mendove se ishte një dërgesë
7 tjetër, apo këtë mendim e pate menjëherë pasi e pe veturën,
8 apo mbase pasi ky njeriu doli, u largua nga vetura?

9 Pë. Pasi pash atë personin që doli nga vetura, e pash që
10 ishte mashkull dhe kishte veshur rroba sportive, maskë dhe
11 kapele.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, kur e pe këtë njeriun,
13 ishte ky momenti kur mendove për herë të parë se mund të ishte
14 një tjetër dërgesë, apo e kishe menduar edhe pak më përpara,
15 më përpara. Të kujtohet kjo?

16 Pë. Nuk është që më kujtohet saktësisht po e di që nga
17 lëvizjet që i kanë bërë, vetëm e kam shikuar dhe ju kam lutur
18 Pajtimit të xhiron. Dhe ai ka dalun nga vetura, e kam lutur
19 shumë të fillojë të xhirojë. E kam tërheqë vëmendjen nga
20 vetura, nuk më ka interesuar, vetëm jam fokusuar në atë
21 personin që kishte pakon në duar.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Ballhazi, pyetja
23 tjetër ka të bëjë me paragrafin 13 të deklaratës që thotë, po
24 citoj:

25 "Pas pak, e pashë po ashtu të njëjtin person duke dalë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykes

Faqe 50

1 nga zyrat e OVL UÇK-së dhe u kthye në të djathtë pasi që doli
2 nga zyrat". Pra mbaron citimi.

3 Thoni këtu "pas pak". Sa pas pak, pesë minuta? Dhjetë
4 minuta? Pra pas pesë minutave, pas dhjetë minutave. Sa kohë
5 zgjati nga momenti që hyri ky njeri në zyrat e OVL UÇK-së dhe
6 deri në momentin kur doli prej këtyre zyrave dhe u largua?
7 Afërsisht.

8 Pë. Nuk e mbaj mend.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po një vlerësim të përafërt,
10 më shumë se dy minuta? Më shumë se pesë minuta? Dhjetë minuta?
11 Pesëmbëdhjetë minuta?

12 Pë. Dhjetë minuta ndoshta janë shumë, por nuk e mbaj mend
13 saktë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja tjetër ka të bëjë me
15 paragrafin 22 të deklaratës që ke dhënë. Këtu shkruhet:

16 "Isha në korridor kur në zyra erdhën hetuesit nga ZPS-ja.
17 Ata hynë në një takim në një zyrë me Nasim Haradinajn dhe
18 Hysni Gucatin për disa orë. Pastaj Tom Gashi, avokati që e
19 përfaqëson OVL UÇK-në, po ashtu hyni në takim për një kohë
20 të gjatë". Përfundoj leximin këtu nga deklarata juaj.

21 Zonja Ballhazi, kjo ka ndodhur në të njëjtën ditë që u
22 sollën dokumentet, pra që erdhën dokumentet kur ti e pe këtë
23 njeriun e panjohur që i solli dokumentet, apo kjo ka ndodhur
24 në ditë tjetër?

25 Pë. Jo, kjo ka ndodhur po atë ditë, me 16 shtator, kur

1 janë dërguar dosjet.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra i vutë, e vutë re, siç
3 është përshkruar këtu në deklaratën tënde në 22, hetues të
4 ZPS-së, patë hetues të ZPS-së më datë 16 shtator, pra po atë
5 ditë, kur pe ardhjen e dokumenteve. Kështu?

6 Pë. Të thashë që po atë ditë ka ndodhur kjo.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Ballhazi, nga e dinit
8 që këta persona që patë atë ditë ishin anëtarë të ZPS-së?
9 Pë. Sa e mbaj mend, aty dikush ka folur, nuk më kujtohet
10 saktë, a gazetar apo kameraman, se kemi qenë kolegë, se po
11 vijmë hetuesit nga ZPS. Asgjë tjetër. Vetëm e kam dëgjuar.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra e dëgjuat, por nuk patë
13 personalisht nuk patë ndonjë hetues të ZPS-së, njerëz të
14 veshur me xhaketa, me shenjën e ZPS-së?

15 Pë. Nuk e mbaj mend, por e mbaj mend vetëm ku janë larguar,
16 që nuk kanë përshëndetur neve gazetarëve.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Ballhazi, pasi këta
18 njerëz u larguan, sipas paragrafit 24 të deklaratës suaj,
19 thoni se konferenca për shtyp filloi.

20 Pë. Edhe një herë pyetjen?

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Patjetër. Zonja Ballhazi,
22 sipas paragrafit 24 të deklaratës suaj, këtu ju shkruani, dhe
23 po citoj:

24 "Sapo shkuan hetuesit e ZPS-së, filloi konferenca për
25 shtyp". Mbyllet këtu citimi. Kështu ka qenë?

1 Pë. Po.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zonja Ballhazi, ti vetë more
3 pjesë në konferencën për shtyp, gjatë konferencës për shtyp
4 ishit aty?

5 Pë. Po, aty kam qenë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim]A kishte ndonjë dokument apo
7 kopje dokumentesh të cilat gazetarët mund t'i merrnin gjatë
8 konferencës për shtyp?

9 Pë. E mbaj mend që konferenca për shtyp është mbajtur aty te
10 holli i korridorit. Më shumë nuk më kujtohet.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra konferenca për shtyp,
12 siç të kujtohet tani, është zhvilluar në korridor dhe jo në
13 një sallë apo dhomë më vete. Ishte në korridor, kështu?

14 Pë. Në korridor, ishte aty zoti Hysni Gucati, Nasim Haradinaj
15 dhe avokati, Tom Gashi dhe disa përfaqësues të tjerë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa herë, zonja Ballhazi ke
17 qenë e pranishme gjatë këtyre ditëve, të themi nga data 16
18 shtator deri më datë 17 shtator, në zyrat e OVL UÇK-së? Vetëm
19 një herë apo më shumë?

20 Pë. Më shumë se një herë sepse është detyra ime, dhe jam
21 gazetare të ndjek ngjarje.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Zonja Ballhazi,
23 pyetja ime e fundit ka të bëjë me paragrafin 31 të deklaratës
24 suaj, që lexon kështu, dhe po citoj:

25 "Dua të them që në asnjë moment, as ZPS-ja, as askush

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga znj. Stephenson

Faqe 53

1 tjetër, nuk më kanë kontaktuar pasi që kam qenë në zyrat e OVL
2 UÇK-së atë ditë, nuk më kanë pyetur personalisht dhe askush
3 nga ZPS-ja nuk e ka kontaktuar arbresh.info, median ku kam
4 qenë duke punuar në atë kohë në vitin 2020”.

5 Zonja Ballhazi, ti vetë apo ndonjë person tjetër nga
6 arbresh.info, a e ka informuar ZPS-në se keni filmimin me
7 video ku dukej ardhja e dokumenteve?

8 Pë. Nuk po e kuptoj pyetjen të lutem?

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për shembull, i keni dërguar
10 ndonjë email zyrës së ZPS-së ku t’i tregonit që zotëronit një
11 incizim në video, apo që arbresh.info ka në zotërim një
12 incizim me video ku dukej ardhja e dokumenteve, apo u
13 lajmëruat me telefon, ti vetë apo dikush nga arbresh.info?
14 ZPS-në bëhet fjalë.

15 Pë. Jo.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam
17 pyetje të tjera.

18 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] A mund të bëj edhe unë disa
19 pyetje të tjera ju lutem?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Po.
21 Faleminderit.

22 Pyetje vijuese nga znj. Stephenson:

23 Py. Zonja Ballhazi, a ishit e pranishme në konferencën e
24 tretë për shtyp më datë 22 shtator?

25 Pë. Po, kam qenë.

1 Py. Sa qartë ju kujtohen që të kenë qenë zyrtarët e ZPS-së të
2 pranishëm më datë 16 shtator apo më datë 22 shtator?

3 Pë. Unë vetëm i mbaj mend që kanë qenë me maska dhe kapele
4 dhe disa çanta në duar. Asgjë tjetër nuk mbaj mend.

5 Py. A jeni e sigurt që punonjësit e ZPS-së kanë qenë të
6 pranishëm me datë 16, apo mbase mund të kenë qenë të pranishëm
7 më datë 22 shtator dhe ju mund t'i ngatërroni këto dy data?

8 Pë. Nuk po më kujtohet më saktësisht.

9 Py. Pra a jeni e sigurt që punonjësit e ZPS-së kanë qenë të
10 pranishëm më datë 16 apo mbase mund të ketë qenë që kanë qenë
11 të pranishëm më datë 22? Sa qartë ju kujtohet, sa fort ju
12 kujtohet fakti që punonjësit e ZPS-së kanë qenë të pranishëm
13 në OVL UÇK? Sa të kthjellëta i keni këto kujtime?

14 Pë. Unë e thashë edhe në pikën e deklaratës sime, në njërin
15 nga pikat që aty e kam marrë vesh që kanë se do të vijnë
16 hetues të ZPS-së. Unë nuk i kam parë duke hyrë, por i kam parë
17 vetëm duke u larguar. Neve gazetarëve nuk na kanë
18 përshëndetur. Kanë qenë me maska, kapele, dhe çanta.

19 Py. Për cilën datë e keni fjalën?

20 Pë. Datën kur unë e kam bërë video xhirimin, 16 shtator.

21 Py. Faleminderit. Edhe një pyetje të fundit, a jeni e sigurt
22 që Tom Gashi ishte i pranishëm në konferencën e dytë për
23 shtyp, apo ka qenë i pranishëm në konferencën e tretë për
24 shtyp, apo nuk jeni e sigurt?

25 Pë. Ka qenë i pranishëm në konferencën e dytë, ku aty kemi

1 marrë vesh edhe ne media se do të jetë përfaqësues.

2 Py. Faleminderit, nuk kam më pyetje të tjera.

3 Z. WORBOYS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 Pyetje të palës tjetër nga z. Worboys:

5 Py. Një pyetje nga unë. Ka të bëjë me paragrafin 1 të
6 deklaratës suaj.

7 Z. WORBOYS: [Përkthim] Ju lutem ta nxjerrim në ekran, për
8 hir të procesverbalit.

9 Py. Sa i takon paragrafit 1 të deklaratës suaj, a është saktë
10 që mund ta përshkruajmë takimin tuaj me zotin Cadman në mars
11 të vitit 2021 thjesht si një takim paraprak për të parë
12 çështjet?

13 Pë. Po.

14 Py. A mund të thoshim po kështu, se pasi u takuat me zotin
15 Cadman, u morët në intervistë më pas nga anëtarë të tjerë të
16 ekipit të Mbrojtjes me qëllim që të merrej dëshmia juaj?

17 Pë. Po.

18 Z. WORBOYS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Druaj se tani kemi shumë pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

21 [Mikrofoni çaktivzuar] Faleminderit.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshirojmë që t'ju marrim leje që
23 të bëjmë pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ah, unë

25 kujtoja se thatë që s'kishit fare --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 56

1 Z. HALLING: [Përkthim] Kemi shumë. Kërkoj ndjesë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Në
3 rregull. Vazhdoni.

4 Pyetje të palës tjetër nga Z. Halling:

5 Py. Zonja Ballhazi, do të bëjmë disa pyetje.

6 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares që të nxjerrë
7 videon P12 në ekran. Transkriptimi është P12-ET.

8 Py. Zonja Ballhazi, do të lëshojmë tani një video të
9 konferencës për shtyp të OVL UÇK-së dhe do t'ju bëj disa
10 pyetje.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Me të dalë video në ekran, do t'ju
12 lutem që ta lëshoni videon nga fillimi i videos deri në një
13 minutë. Klasifikimi i videos është publik.

14 [Luhet videoincizimi]

15 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

16 Py. Zonja Ballhazi, ju keni qenë e pranishme në këtë
17 konferencë për shtyp, apo jo?

18 Pë. Po.

19 Py. Në fakt, ju shohim në ekran në fillim të kësaj videoje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Duhet të
21 përgjigjeni me "po" ose "jo", zonjë.

22 DËSHMITARJA: Po.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

24 Py. Faleminderit. Është sepse seanca hidhet në procesverbal
25 dhe duhet me thënë me fjalë.

1 A është kjo konferenca për shtyp që ti e kujton në
2 deklaratën me shkrim për të cilën ju bëri pyetje Gjykatësi më
3 përpara?

4 Pë. Me sa më kujtohet kjo është konferenca e tretë, kur janë
5 sjellë dosjet në Rrufenë 3.

6 Py. A është kjo konferencë për shtyp që ti e kujton në
7 deklaratën, këtu, të dëshmitarit?

8 Pë. Të thash pak më parë, mendoj që kjo është deklarata, kjo
9 është konferenca, më fal, e tretë të Rrufesë 3.

10 Py. Zonja dëshmitare, në videon që pamë këtu, zoti Haradinaj
11 tha që do të na sjellë CD me më shumë. E dëgjuat në video?

12 Pë. Po e dëgjova.

13 Py. Në lidhje me paragrafin 26 të deklaratës suaj, po citoj,
14 thuhet se:

15 "Gjatë konferencës, Nasim Haradinaj ka thënë se ai
16 personi kishte thënë që do të sjellë dosje të tjera. Të
17 kujtohet kjo?

18 Pë. Edhe një herë pyetjen të lutem.

19 Py. A të kujtohet që sapo thashë, që sapo lexova nga
20 deklarata jote? E lexova nga deklarata jote. Mund ta lexoj
21 përsëri, nëse dëshironi.

22 Pë. [E padëgjueshme].

23 Py. "Gjatë konferencës, Nasim Haradinaj ka thënë se ai
24 personi kishte thënë që do të sjellë edhe dosje të tjera".

25 E ke thënë këtë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 58

1 Pë. Po. [E padëgjueshme].

2 Py. Zoti Haradinaj tha diçka shumë të ngjashme në fillim të
3 videos që sapo dëgjuam, po kjo është një konferencë tjetër për
4 shtyp për të cilën ti e ke fjalën këtu. Kështu po dëshmoni
5 këtu?

6 Pë. Unë mendoj se kjo është konferenca e tretë kur janë
7 dosjet në Rrufenë 3-shi. Po e përsëris për të tretën herë.

8 Py. Zonja dëshmitare, dëshiroj që të shfaq një video tjetër.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Është me numër P4, zonja
10 Sekretare, të lutem ta nxjerrë në ekrane. Është po kështu
11 publike. Vula kohore që kërkoj të lëshohet është nga fillimi i
12 video deri në 35 sekonda.

13 Py. Zonja dëshmitare, do të shfaqim një pjesë të kësaj video
14 dhe pastaj do t'ju bëj pyetje të tjera lidhur me këtë.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, zonja Sekretare.

17 Py. Zonja Ballhazi, keni qenë në këtë ngjarje?

18 Pë. Po. Jam aty avokatit Tom Gashi.

19 Py. A është kjo konferenca për shtyp për të cilën e ke fjalën
20 në deklaratën tënde?

21 Pë. Po kjo është më duket dyshi, kur janë sjellë dosjet në
22 Rrufenë 2-shi. Më duket se kjo, sepse ka kaluar një proces mbi
23 15 muaj nuk është se e kam memorien e freskët.

24 Py. E kuptoj, dhe e njihni Tom Gashin në pamje, në këtë pamje
25 që ka mbetur e ngrirë në ekran?

1 Pë. Po.

2 Py. Zonja Ballhazi, nëse unë të them që kjo video të them që
3 kjo video është e datës 17 shtator, 2020, çfarë do thoshe?

4 Pë. Unë kam thënë se datat nuk i mbaj mend shumë saktë, 16
5 apo 17. Është pra shtatori, është e ditë që kanë qenë, Rrufeja
6 2-shi kur është sjellun në OVL. Është cilësuar ashtu, Rrufeja
7 2.

8 Py. Por në deklaratë ke thënë që Rrufeja 2 ka ndodhur në datë
9 16 shtator, po thua që Rrufeja 2 ka ndodhur më 17?

10 Pë. 16 aty, këtu e kam përmendur vetëm në shtator të vitit
11 2020.

12 Py. Zonja dëshmitare, në paragrafin 3 të deklaratës thuhet
13 kështu:

14 "Më 16 shtator 2020, diku ndërmjet orës 11.00 e kam parë
15 një veturë të bardhë..." etj., etj. Pra këtu e thoni që është
16 16 shtator.

17 Pë. Me 16 shtator, e kam cituar. Ose --

18 Py. Në lidhje me videon që pamë, që u pranua kur po bënte
19 pyetje Mbrojta e Gucatit, kjo video nëse të ka ndodhur me 16
20 shtator, atëherë a je e sigurt që kjo video që unë e shfaqja
21 tani ka ndodhur në të njëjtën ditë me atë?

22 Pë. Edhe një herë pyetjen të lutem?

23 Py. Të kujtohet videoja që jua shfaqti pak më përpara Mbrojtja
24 e Gucatit?

25 Pë. Jeh.

1 Py. Videoja që ju tregoi Mbrojtja e Gucatit dhe video që unë
2 ju tregova, a janë marrë në të njëjtën ditë?

3 Pë. Nuk është që e mbaj mend shumë por më është duke se është
4 e njëjta ditë. Më duket.

5 Py. Zonja Ballhazi, në seancën përgatitore me Mbrojtjen
6 përpara dëshmisë suaj këtë javë, a është e saktë që keni thënë
7 që i ngatërroni paksa datat. Kështu?

8 Pë. Është një proces që është 15 muaj dhe kanë ndodhur edhe
9 shumë ngjarje të tjera. Nuk është që i mbaj mend të gjitha.

10 Py. Kuptoj.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshiroj të shfaq tani një video
12 tjetër. I lutem Sekretares së Gjykatës që të nxjerrë në ekran
13 me numër ERN 10428401. Nuk ka numër prove, është dokument
14 publik. Transkriptimi në anglisht është 10428401-TR-ET. I
15 kërkoj sekretares që të shfaqë këtë videon që nga fillimi deri
16 në 28 sekonda.

17 Py. Dhe, zonja dëshmitare, kam disa pyetje lidhur me këtë
18 pastaj.

19 [Luhet videoincizimi]

20 Z. HALLING: [Përkthim]

21 Py. Zonja dëshmitare, e njihni që jeni vetë ju në video?

22 Pë. Po, unë jam.

23 Py. Është një intervistë që ke bërë me bashkëshorten e Nasim
24 Haradinajt, pas arrestimit të tij. Kështu?

25 Pë. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 61

1 Py. Zotin e Haradinaj e quajtet një person me drejtësi të
2 plotfuqishme. Pse ishte zoti Nasim Haradinaj person me
3 drejtësi të plotfuqishme?

4 Pë. Duke e ditur se kam qenë vetëm 4 vjeç e gjysmë që e kam e
5 kam përjetuar luftën e Kosovës edhe sot në sallën e Gjyqit ku
6 po mbushen 27 vite, në Kosovë po e festoj, dhe për zotin
7 Haradinaj kam respekt dhe për të gjithë ata luftëtarë që
8 luftuan që unë sot ta gëzoj lirinë. E kam cilësuar kështu
9 sepse ky dhe shumë persona të tjerë në Kosovë kanë vuajtur
10 burgun padrejtësisht.

11 Py. Sa kohë ke që e njihni Nasim Haradinajn?

12 Pë. E kam parë vetëm në televizion. Nuk është që kam pasur
13 shumë afërsi me të.

14 Py. A e keni intervistuar ndonjëherë zotin Haradinajn?

15 Pë. Ndoshta. Një deklaratë të shkurtër ja kam marrë dhe më
16 shumë jo.

17 Py. A e mbani mend se kur e keni marrë këtë deklaratë të
18 shkurtër?

19 Pë. Nuk e mbaj mend.

20 Py. Zonja dëshmitare, kur u arrestua Hysni Gucati, me 25
21 shtator të vitit 2020, ky ishte një lajm i madh në Kosovë. A
22 jeni dakord me këtë?

23 Pë. Po.

24 Py. Përpara se sa Nasim Haradinaj të arrestohej në të njëjtën
25 ditë, ai bëri disa komente publike. A jeni në dijeni të kësaj?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 62

1 Pë. Jo, nuk jam.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se Sekretarja mund të
3 shfaqë dokumentin P4, që është një dokument ose më mirë është
4 një video publike. Dhe jam i interesuar që të shfaqni
5 fragmentin nga sekonda 26 deri në sekondën 35.

6 Sa për përkthyesit, doja të them që duket sikur njerëzit
7 flasin por në fakt nuk ka skript.

8 Py. Domethënë, do të doja që t'ju kërkoja ta shikonit.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, në fakt kam
10 dhënë referencën e gabuar. Tani dua që të shfaqni P27. Por
11 vula e kohës është e njëjta.

12 [Luhet videoincizimi]

13 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

14 Py. Zonja dëshmitare, jeni ju në këtë video apo jo?

15 Pë. Po.

16 Py. Dhe kjo është një intervistë ekskluzive që ju po bëni me
17 zotin Haradinaj ditën në të cilën ai është arrestuar. A është
18 kështu?

19 Pë. Nuk e mbaj mend.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar, vetëm një çast ju
21 lutem.

22 [Përfaqësuesit e Prokurorisë së Specializuar
23 këshillohen]

24 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, më thuhet që
25 është me datë 22 shtator ky regjistrim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 63

1 Py. Zonja dëshmitare, pyetja që kam për ju tani është kjo: si
2 e siguroat ju këtë intervistë ekskluzive?

3 Pë. Përderisa isha duke pritur, përfundoi konferenca, më
4 duket sa e mbaj mend, dhe i kam thënë vetëm një deklaratë të
5 shkurtër lidhur -- vetëm për portalin tim dhe e di që ka qenë
6 i zënë dhe vetëm shkurt më duket se e kam realizuar, sepse unë
7 kam qenë në ndjekje të lajmeve dhe jam gazetare.

8 Py. [Nuk ka përkthim].

9 Pë. Përkthimi ju lutem --

10 Py. Ju thatë që kjo ishte pas konferencës për shtyp me datë
11 22 shtator, apo jo?

12 Pë. Po, më duket.

13 Py. Dua t'ju tregoj një fragment të shkurtër nga kjo
14 konferencë për shtyp.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është
16 dokumenti me numër identifikimi P3, dhe transkriptimi është
17 P35-ET. Pjesa që dua që të shfaqet është nga 23:15 deri në
18 23:40.

19 Për këtë video, vulat e kohës në transkriptim janë pak të
20 ndryshme sepse vijnë nga dy burime të ndryshme.

21 Për përkthyesit, dua t'ju them që pjesa përkatëse për
22 transkriptim është nga fragmenti 26:46 deri në fragmentin
23 27:21 dhe tani dua t'i kërkoj Sekretares që ta shfaqë këtë
24 video.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 Py. Zonja Ballhazi, e patë veten në këtë regjistrim?

3 Pë. Po.

4 Py. Në fragmentin që ne pamë juve i pëshpëritët diçka në vesh
5 zotit Haradinaj. A nuk është kështu? E patë këtë gjë?

6 Pë. Po, e pashë.

7 Py. Çfarë i thatë atij?

8 Pë. Ndoshta i kam thënë për atë intervistën që ta kem, pas
9 konferencës, ta kem ekskluzive. Mendoj.

10 Py. Dhe ai ra dakord, apo jo?

11 Pë. Ju e patë edhe më herët, që ma shfaqët intervistën. Ajo
12 është.

13 Py. Sa shpesh keni folur me zotin Haradinaj në shtator të
14 vitit 2020?

15 Pë. Nuk e di, nuk e mbaj mend.

16 Py. A ke marrë në telefon?

17 Pë. Ndoshta e kam marr në telefon për të dhënë ndonjë
18 deklaratë. Më shumë s'di sepse unë e kam detyrën e gazetares
19 dhe është detyrë e imja.

20 Py. Zonja dëshmitare, dua t'ju lexoj pjesë të paragrafit 17
21 të deklaratës tuaj. Ju thatë që kur shkuat për të parë OVL-në
22 e UÇK-së, zoti Haradinaj "...pastaj doli në korridor e më
23 bërtiti, duke pyetur vazhdimisht: "Përse je këtu? Përse je
24 këtu? Je bërë si CIA"".

25 E mbani mend këtë pjesë të deklaratës tuaj?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 65

1 Pë. Po, e mbaj mend sepse ai ishte shumë i shqetësuar dhe
2 ishte shumë i tensionuar, i skuqur. E pash në fytyrë.

3 Py. Pse ajo çfarë po bënit juve ishte sikur ishit e CIA-s? Si
4 e kuptoni këtë gjë?

5 Pë. Ndoshta ka bërë ndonjë shaka.

6 Py. E kishte fjalën për faktin që e kishit kontaktuar shpesh
7 apo jo?

8 Pë. Atë nuk e di.

9 Py. A keni bërë ndonjëherë ndonjë postim në Facebook në
10 mbështetje të të akuzuarve në këtë çështje?

11 Pë. Të them të drejtën, e kam pasur një Facebook. Aty e kam
12 publikuar gjithë detyrën time si gazetare, të gjitha videot,
13 por më është mbyllur në prill të këtij viti, më është hakuar,
14 dhe tash e kam një Facebook tjetër. Sepse jam gazetare dhe më
15 është hakuar. Nuk e di pse.

16 Py. Zonja Ballhazi, nuk ju përgjigje pyetjes. Pyetja ime
17 ishte kjo: a keni bërë ndonjë postim në Facebook në mbështetje
18 të të akuzuarve? A mund t'i përgjigjeni kësaj pyetje, ju
19 lutem?

20 Pë. Nuk më kujtohet nëse kam bërë ndonjë kësi lloj
21 mbështetje.

22 Py. Dhe ju thoni që ju është mbyllur adresa e Facebook-ut në
23 prill të këtij viti. Pse të është mbyllur?

24 Pë. Pasi që jam gazetare e terrenit dhe gazetare hulumtuese,
25 unë kam bërë edhe shumë tema të tjera në Kosovë, jo vetëm për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 66

1 këtë proces, po kam bërë edhe tema të tjera. Nuk e di arsyen.

2 Py. Nga provat që dhatë më përpara, kjo ka ndodhur rreth një
3 muaj përpara se të takoheshit me zotin Cadman. Është e saktë
4 kjo?

5 Pë. Po.

6 Py. Zonja Ballhazi, a e konsideroni veten si mbështetëse të
7 OVL-së së UÇK-së?

8 Pë. Së pari më lejo të sqaroj se unë jam mbështetëse e së
9 pari e detyrës sime si gazetare. Jam mbështetëse e vlerave të
10 luftës, sepse kam qenë një fëmijë i vogël që kam kaluar
11 kufirin e Maqedonisë për të kaluar në fshatin Bllacë, sepse
12 jam nga Hani i Elezit, për të kaluar në kamp.

13 Py. ZPS-ja a ka qenë ndonjëherë e interesuar që të fliste me
14 ju? Dhe në qoftë se do ju kontaktonte ZPS-ja, do i kishit
15 treguar OVL-së së UÇK-së për këtë gjë?

16 Pë. Nuk po e kuptoj pyetjen.

17 Py. Do ta përsëris edhe një herë. Në qoftë se do të kishte
18 kontaktuar ZPS-ja, pra, në qoftë se do të kishte qenë e
19 interesuar që të kontaktonte me ju, a do ja kishit thënë, do
20 ja kishit treguar këtë gjë OVL-së së ZPS-së?

21 Pë. Nuk e di.

22 Py. Ju jeni sot këtu sepse mbështesni të akuzuarit. A është e
23 vërtetë kjo?

24 Pë. Së pari më lejo të sqaroj, sepse unë këta dy persona,
25 zotin Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucatin, nuk i quaj të

1 akuzuar.

2 Py. Pse nuk janë të akuzuar?

3 Pë. Po mbahen padrejtësisht këtu.

4 Py. Po pse, pse mendon këtë?

5 Pë. E mendoj për të vetmen arsye se rrjedhja e dokumenteve ka

6 ndodhur vetëm nga -- mendoj që ka ndodhur vetëm nga zyra e

7 ZPS-së sepse Gjykata është këtu në Holandë dhe nuk është në

8 Kosovë. Pse e lejuat pra rrjedhjen e këtyre dosjeve? Unë

9 mendoj që këta po mbahen peng dhe jo të akuzuar.

10 Py. Kur thoni që mendoni që dokumente kanë rrjedhur nga ZPS-

11 ja, çfarë prove ke ti këtë ti për këtë prezumim tuajin, në

12 qoftë se ke ndonjë ?

13 Pë. Ky është mendimi im si gazetare.

14 Py. Çfarë faktesh e mbështesin këtë opinion tuaj?

15 Py. Është mendimi i lirë i imi si gazetare.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam

17 pyetje të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Keni

19 ndonjë gjë tjetër për të pyetur, zonja Stephenson?

20 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Në qoftë së më lejoni, dua të

21 bëj edhe disa pyetje të tjera.

22 Pyetje vijuese të mëtejshme nga zonja

23 Stephenson:

24 Py. Zonja Ballhazi, duam që të sqarojmë datën e regjistrimit.

25 E kam fjalën për regjistrimin video të cilën ua treguam pak më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Stephenson

Faqe 68

1 përpara.

2 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Zonja Sekretare, ju
3 lutem a mund të shfaqni edhe një herë në ekran dokumentin
4 DHG0495? Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

5 Zonja sekretare, ju lutem shfaqeni regjistrimin dhe
6 ndalojeni kur të them që ta ndalosh.

7 [Luhet videoincizimi]

8 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Ndalojeni tani, ju lutem.
9 Py. Zonja Ballhazi, a mund ta shohësh pak burrin që është në
10 ekran? E shikon?

11 Pë. Po.

12 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Zonja Sekretare, ju lutem a
13 mund të shfaqni në ekran dokumentin, provën materiale
14 DHG081971-10.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është në listën e
16 dokumenteve të Mbrojtjes?

17 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Jo, nuk është më listën tonë.
18 Sepse menduam që kishim rënë dakord për faktet.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk po e gjejmë dot këtë
20 dokumentin në dokumentin me ERN-në që përmendi zonja
21 Stephenson.

22 Për aq kohë sa pyetja ka të bëjë me regjistrimet në
23 kamera. Janë dokumentet të cilat fillojnë me 091925 në fillim.

24 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Jo, nuk është kështu. Në fakt
25 është dokumenti që ka numrin e identifikimit 081979-10.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Stephenson

Faqe 69

1 Zonja Sekretare, a mund të na e shfaqësh këtë video?

2 [Luhet videoincizimi]

3 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] A mund ta ndaloni tani

4 videon, zonja Sekretare?

5 Py. Zonja Ballhazi, a e patë këtë burrin që u fut në të

6 majtë, poshtë ekranit?

7 Pë. Po.

8 Py. A mund të konfirmoni që ky është personi që keni parë me

9 kutitë jashtë godinës së OVL-së së UÇK-së?

10 Pë. Po.

11 Py. A mund të konfirmoni që në të djathtë -- nuk është shumë

12 e qartë në fakt, por gjithsesi, a mund ta shikoni që është

13 data 16 shtator 2020? E konfirmoni këtë?

14 Pë. Këtu lart, a po?

15 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Zonja Sekretare, a mund ta

16 shfaqësh edhe një herë pak më tepër, në mënyrë që ta shikojmë

17 pak më qarët datën.

18 Py. A mund ta shihni datën?

19 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] A mund ta shfaqni edhe një

20 herë pak më tej. Ju lutem, në momentin kur të jetë më e qartë

21 data ndalojeni videon.

22 Py. Pra mund ta shikoni besoj që është data 16 shtator 2020?

23 Pë. Po.

24 Py. Faleminderit. A mendoni që të jetë e mundur që ju të

25 shkoni në zyrat e OVL UÇK-së ditën e nesërme, domethënë me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Stephenson

Faqe 70

1 datë 17, a mund të jetë e mundur kjo?

2 Pë. Pasi që e kam parë atë personin, unë pastaj kam vazhduar
3 direkt zyrave lart të OVL-së për të marrë një deklaratë.

4 Py. Po, e kuptoj këtë. Pyetja ime është kjo: a është e mundur
5 që ju të keni shkuar në zyrat e OVL-së edhe ditën tjetër,
6 domethënë ditën pasi e patë këtë burrin që kishte kutitë që i
7 dërgoi në OVL të UÇK-së, domethënë në qoftë se keni shkuar në
8 zyra me datë 17 shtator 2020?

9 Pë. Ndoshta kam shkuar, nuk është që e mbaj mend mirë. Për
10 shkak se është se kam harruar.

11 Py. Edhe një pyetje të fundit. Ju personalisht ose ndonjë
12 person, a keni kërkuar që video të bëhet publike në ndonjë
13 mënyrë?

14 Pë. Të them të drejtën, sa kam pritur të mbahet konferenca,
15 askush nga kolegët nuk e ka ditur se unë e kam këtë video. As
16 nuk e kam bërë fjalë me askënd. Pasi që ka përfunduar
17 konferenca, kam vazhduar te zyrat e arbresh.info dhe kam
18 biseduar me hierarkinë përgjegjëse, kryeredaktoren dhe
19 redaktoren dhe pastaj jemi dakorduar që ta publikojmë.

20 Py. Si e botuat këtë, si e publikuat këtë video?

21 Pë. E publikuam në portalin arbresh.info që është në Facebook
22 dhe në YouTube që kanë kanalet.

23 ZNJ. STEPHENSON: [Përkthim] Në rregull, nuk kemi pyetje
24 të tjera, të nderuar Gjykatës. Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Zoti Worboys, ndonjë gjë tjetër?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Me lejen tuaj, duam të bëjmë një
4 pyetje tjetër. Megjithatë, mund të vazhdojë zoti Worboy në
5 fillim.

6 Z. WORBOYS: [Përkthim] Për momentin nuk kemi asnjë
7 pyetje, por mbase mund të kemi pasi të përfundojë zoti
8 Halling.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Diçka shumë shkurt, lidhur me
10 foton që kemi në foton që është e ngrirë në ekran.

11 Pyetje vijuese të mëtejshme të palës tjetër nga

12 z. Halling:

13 Py. A e shikoni kohën që është këtu, që është 15.32, vulën e
14 kohës në video?

15 Pë. Po, e shoh pak të turbullt.

16 Py. A është kjo koha kur është lënë kjo paketë?

17 Pë. Këtë kam thanë edhe më herët, që nuk është që i mbaj mirë
18 mend kohët se është proces pesëmbëdhjetë muaj dhe kam pas
19 ngjarje të tjera të përcjell si gazetare. Nuk është që jam
20 fokusuar vetëm këtu.

21 Py. Ju thatë në paragrafin 3 të deklaratës tuaj që kjo makina
22 që keni parë ka ardhur në periudhën e kohës nga 11.00 deri në
23 12.00. duke parë videon përpara jush, a është e saktë kjo?

24 Pë. Po, e kam thënë këtu në paragraf, por unë e kam bërë edhe
25 kohë hesap se unë kam dalë të marr vox-e me qytetarë, dhe kemi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Elmedina Ballhazi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Stephenson

Faqe 72

1 pasur edhe pauza sepse ka qenë ditë me diell, ka qenë nxehtë
2 dhe jemi ulur edhe të pushojmë.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
5 Worboys, keni ndonjë pyetje?

6 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, nuk kam asnjë pyetje.
7 Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Kemi përfunduar me dëshminë tuaj sot, zonja Ballhazi.
11 Sekretarja do t'ju shoqërojë, do t'ju nxjerrë nga salla.
12 Faleminderit që ishit me ne sot.

13 Dhe gëzuar ditëlindjen edhe 100.

14 [Dëshmitarja largohet]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mbrojtja,
16 jeni gati për zotin Marashi? Zoti Marashi është këtu. Thjesht
17 duhet të fshijnë, të pastrojnë tryezën dhe zoti Bowden do të
18 marrë në pyetje këtë dëshmitar.

19 Në rregull.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Përpara
21 së se atë futet Z. Marashi, a jemi dakord si më përpara, të
22 procedojmë në të njëjtën mënyrë edhe për deklaratën e z.
23 Marashi?

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Jemi në të njëjtën linjë,
25 zoti Gjykatës.

1 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
3 z. Marashi

4 DËSHMITARI: Mirëdita.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

6 Asistentja e sallës do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne
7 të cilën ju kërkohet ta lexoi, në përputhje me rregullën
8 141(2) të Rregullores sonë. Kur të jeni gati, lexojeni me zë
9 të lartë.

10 DËSHMITARI: Betim solemn sipas Rregullores 14(2). I
11 ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësisë
12 time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën,
13 krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, dhe nuk do të mbaj të
14 fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

15 DËSHMITARI: PREN MARASHI

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

17 Faleminderit. Mund të uleni.

18 Z. Marashi, sot do të dëgjojmë dëshminë tuaj. Siç mund të
19 jeni në dijeni, zoti Bowden do t'ju bëjë pyetje fillimisht
20 lidhur me deklaratën tuaj. Pastaj në Gjykatë do të bëhet një
21 diskutim i shkurtër dhe pastaj, një pjesë që do të pranohet e
22 deklaratës tuaj, do lexohet për procesverbalin.

23 Z. Bowden pastaj mund t'ju bëjë disa pyetje të tjera nëse
24 do të ketë. Pastaj, përfaqësuesit avokatë të zotit Haradinaj
25 mund t'ju bëjnë disa pyetje, po ashtu. Pastaj e ka rendin

1 Prokuroria. Edhe anëtarët e Trupit Gjykues mund t'ju bëjnë
2 disa pyetje.

3 Z. Bowden vlerëson se pyetjet që do bëjë ai do të jenë të
4 shkurtra mbase pesëmbëdhjetë minuta. Prokuroria vlerëson që më
5 gjatë, mbase edhe dy orë, por nuk mendojmë që do zgjasë aq
6 gjatë. Trupi gjykues mund të lejojë bërjen e pyetjeve
7 plotësuese nga mbrojtja, nga Z. Bowden, nëse përmbushen
8 kushtet.

9 Ju lutem, përpiquni që pyetjeve t'i përgjigjeni qartë, me
10 përgjigje të shkurtra. Nëse një pyetje nuk e kuptoni, lirisht
11 mund t'ja kërkoni personit që bën pyetjen ta përsërisë dhe t'i
12 thoni që nuk e kuptoni, për ta sqaruar pyetjen.

13 Gjithashtu përpiquni që të tregoni se nga i keni marrë
14 vesh faktet apo rrethanat për të cilat keni dijeni, për të
15 cilat ju bëjnë pyetje. Flisni afër me mikrofonin, prisni pesë
16 sekonda pasi t'ju jetë bërë pyetja dhe flisni ngadalë në
17 mënyrë që përkthyesit të kenë mundësi t'ju përkthejnë.

18 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë sallë dhe në
19 këtë Gjykatë, nuk lejohet që ta diskutoni dëshminë tuaj me
20 asnjë person tjetër. Nëse dikush ju bën pyetje jashtë sallës
21 për dëshminë që keni dhënë këtu, na thoni, na informoni.

22 Z. Bowden. Si edhe në dëshmitarët e mëparshëm, ju lutem
23 pyeteni dëshmitarin nëse deklaratat që ka dhënë pasqyron me
24 saktësi atë që ka thënë ai, pastaj mund të diskutojmë cilat
25 pjesë do pranohet dhe ju mund të lexoni pjesët e pranuarat, dhe

1 pastaj mund të vazhdojmë me pyetjet.

2 Z. BOWDEN: [Përkthim] Faleminderit.

3 Pyetje nga Z.Bowden:

4 Py. Mirëdita, zoti Marashi.

5 Py. Mirëdita.

6 Py. A mund të konfirmoni që emrin, mbiemrin e keni Pren

7 Marashi dhe se datëlindjen e keni 14 korrik 1963?

8 Pë. Po.

9 Py. Z. Marashi, unë e di që anglisht dini paksa por sot
10 dëshminë to ta jepni në gjuhën shqipe, apo jo?

11 Pë. [E padëgjueshme].

12 Py. Shpresoj që ju është dhënë një kopje e deklaratës. Nëse
13 jo, i lutem personelit t'jua japë një kopje.

14 Z. BOWDEN: [Përkthim] Zonja sekretare, versioni në shqip
15 është me numër DHG0144-DHG0147. Versioni në anglisht është
16 DHG0218-DHG0221. Nëse mundet t'i nxjerrim në ekran. Po,
17 faleminderit.

18 Py. Zoti Marashi, ju lutem hidhini një sy deklaratës që keni
19 përpara, të shihni formatin që keni në letër, të shkoni në
20 faqen e fundit, faqen numër 4. A e shihni emrin dhe
21 nënshkrimin dhe datën 28 korrik 2021?

22 Pë. Po.

23 Py. Ky është nënshkrimi juaj?

24 Pë. Po.

25 Py. Dhe deklarata ju është vënë në dispozicion një kopje edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 76

1 më parë?

2 Pë. Po.

3 Py. Jeni në dijeni të përmbajtjes?

4 Pë. Po.

5 Py. Përmbajtja është e vërtetë?

6 Pë. Po.

7 Py. Dhe ju mund të konfirmoni që deklarata pasqyron me

8 saktësi dëshminë që do të jepni këtu në sallë?

9 Pë. Po.

10 Z. BOWDEN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
11 pranohet kjo deklaratë në provat e procesit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
13 [mikrofoni çaktivizuar].

14 E di që keni disa kundërshtime, Z. Halling apo Znj.
15 Bolici.

16 Znj. Bolici, nëse mund të tregoni kundërshtimet dhe
17 arsyet.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] ZPS-ja kundërshton pranimin e
19 paragrafëve nga 22 deri në 24 dhe 26 deri në 28 të deklaratës
20 së këtij dëshmitari. Duke pasur parasysh që çështjet që
21 trajtojnë këto paragrafë nuk kanë lidhje me akuzat e ngritura
22 kundër të akuzuarve. Nuk japin ndonjë informacion faktik dhe
23 konsistojnë në opinion të mbështetura të dëshmitarit për
24 çështje që nuk kanë lidhje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Besoj se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 77

1 Zoti Bowden me sa kam dijeni ju nuk keni kundërshtim për këtë
2 kundërshtim.

3 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Pra jeni
5 të gatshëm që t'i heqim këto pika nga materiali.

6 Z. BOWDEN: [Përkthim] Si më parë, nuk ka kundërshtim që
7 deklaratata të pranohet në format të ndryshuar.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Z.
9 Worboys, keni ndonjë koment?

10 Z. WORBOYS: [Përkthim] Asgjë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
12 lexoni tani deklaratën.

13 Z. BOWDEN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
14 Deklarata thotë kështu:

15 Unë, Pren Marashi, do të them si në vijim.

16 Jam lindur në qytetin e Klinës, i cili gjendet në zonën e
17 Pejës, në veri-perëndim të Kosovës. Tani jetoj në fshatin
18 Gllaviçiç, në komunën e Pejës në Kosovë.

19 Pas shkollës së mesme, u rekrutova në ushtrinë jugosllave
20 në Sarajevë, ku kam qenë prej vitit 1983 deri në vitin 1984.
21 Përpara kësaj, më 1981 kam marrë pjesë në demonstratat në
22 Kosovë me grupet e tjera të aktivistëve kundër Jugosllavisë.
23 Ne paraqisnim gjashtë republika dhe dy krahina të Kosovë dhe
24 gjatë kësaj kohe, kemi shpërndarë broshura në trena dhe
25 autobusë pothuaj gjithkund tjetër, për të njoftuar opinionin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 78

1 lidhur me faktin që Kosova duhej të bëhej republikë. E dija që
2 nëse unë ose ndonjëri nga shokët e mi të grupit aktivistë do
3 të kapeshin, do të mund të burgoseshim prej gjashtë muajve
4 deri në dhjetë vjet. Në atë kohë e dija dhe isha në dijeni që
5 babai i Nasim Haradinajt ishte arrestuar dy herë për
6 aktivitete e tij lidhur me kauzën e dashurisë ndaj atdheut. Më
7 4 prill, të vitit 1998 u futa zyrtarisht në UÇK si ushtar dhe
8 më 5 prill të vitit 1998 u bëra komandant i Batalionit 4 të
9 Brigadës 138, në këmbësorinë e frontit, ku babai i Hysni
10 Gucatit ishte njëri prej ushtarëve të mi të këmbësorisë. Isha
11 në shërbim aktiv prej vitit 1998 deri në vitin 1999. Në vitin
12 2000 u bëra anëtar i TMK-së, Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Pas
13 transformimit nga UÇK-ja isha luteinat-kolonel. Në vitin 2000
14 u martova dhe krijova familje. Prej atëherë e posedoj një
15 fermë të cilën e kam trashëguar nga babai. Ferma gjendet në
16 fshatin Gllaviçiç, në komunën e Pejës të Kosovës.

17 Pasi u formua OVL-ja në Prishtinë, u bëra zyrtar për
18 Organizatës Civile Ushtarake të cilës i referohem si G5. Kur u
19 themelua TMK-ja, isha në ekipin monitorues të ndërlidhjes
20 civile-ushtarake. Kjo ka të bëjë me bashkëpunimin me
21 popullatën civile. Gjëja më e dhimbshme për një ushtar ishte
22 transformimi prej ushtarit në TMK-në. Po ashtu kishim
23 komunikim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, IOM në
24 Kosovë dhe me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në
25 Evropë, OSBE. Aso kohe nuk kishim infrastrukturë në TMK. Në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 79

1 koordinim me stafin komandues, i çonim njerëzit në trajnime të
2 ndryshme dhe i koordinonim ish-ushtarët. Unë isha vetëm një
3 hallkë e zinxhirit.

4 Menjëherë pas luftës, në vitin 2000, ne e krijuam një
5 organizatë për veteranët e luftës - Organizatës së Veteranëve
6 të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. OVL UÇK, me
7 qëllimin kryesor që t'i mbështetnim invalidët e familjet e
8 veteranëve.

9 Prej vitit 2000 deri në vitin 2019 u bëra anëtar i
10 kryesisë që më vonë u bë këshilli drejtues i OVL-së, një grup
11 prej 61 anëtarësh. Isha po ashtu edhe udhëheqës i degës për
12 organizatën.

13 Në vitin 2019 hoqa dorë nga kryesia pasi që Hysni Gucati
14 dhe Nasim Haradinaj u zgjodhën kryetar dhe nënkryetar. Ja
15 dhashë pozitën time dikujt tjetër në mënyrë që të mos udhëtoja
16 në Prishtinë tërë kohën, meqë udhëtimi nuk kompensohej. Duhej
17 të udhëtoja 180 kilometra çdo ditë, vajtje-ardhje. U bë një
18 ngarkesë e madhe për mua.

19 Hysniu dhe Nasimi kishin të kaluar patriotike ushtarake
20 kështu që e dija që ata do të na përfaqësonin mirë. Ende jam
21 anëtar i këshillit drejtues. Në maj të vitit 2011 ne njëzëri u
22 pajtuam si kryesi të mos bashkëpunonim me Dhomat e
23 Specializuara të Kosovës (DHSK), me Misionin e Bashkimit
24 Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX dhe me
25 misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, në asnjë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 80

1 mënyrë, sepse nuk i besonim asnjërit prej tyre. E dinim që
2 liria e Kosovës nuk do të kishte arritur pa ndihmën e
3 bashkësisë ndërkombëtare, por DHSK-ja po merrej me vetëm me
4 ndjekjen penale të shqiptarëve dhe jo të serbëve, she kjo
5 është arsyeja përse nuk u besojmë atyre. Në Tribunalin
6 Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, TPNJ-në, kishte me qindra
7 raste kur shqiptarët e Kosovës janë shfajësuar. Ne kemi pasur
8 me qindra raste të vrasjes të pjesëtarëve të UÇK-së dhe askush
9 nuk i ka hetuar këto raste. EULEX-i ka ardhur këtu për të
10 këshilluar por në fund e morën rolin e Prokurorit.

11 Dëshiroj të përshkruaj ngjarjet e datës 8 shtator, 2020,
12 kur ZPS-ja erdhi në zyrat e OVL-së. Asokohe isha në hapësirat
13 e restorantit me Faton Klinakun.

14 Erdhën dy hetues nga ZPS-ja, së bashku me dy përkthyes.
15 Nuk ua dija emrat. Më vonë mora vesh që njëri ishte suedez,
16 por dukej si kinez dhe thanë që ishin nga ZPS në DHSK.

17 Isha i irrituar nga sjellja e hetueseve të ZPS-së. ZPS-ja
18 e di që OVL UÇK-ja nuk e njeh DHSK-në dhe nuk do të
19 bashkëpunojë me ta. Askush nuk mundet të na detyrojmë të
20 flasim me ata njerëz. Njëri prej hetuesve vazhdoi që qëndronte
21 në këmbë dhe nuk pranonte të ulej. Njeriu që qëndronte në
22 këmbë, që ishte i maskuar, tha që ishte këtu për siguri. Ne ju
23 thamë hetuesve të ZPS-së: "A e dini ku jeni? Jeni në zyrat e
24 OVL UÇK-së. Ne ofrojmë siguri". Fatoni u tha atyre se nëse nuk
25 uleshin nuk do kishte takim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 81

1 Më në fund ai u ul, u relaksua piu kafe dhe filloi të
2 ishte më i sjellshëm. Në zyrë në atë kohë ishte Fatoni, Çel
3 Gashi dhe unë.

4 ZPS-ja kërkonte që t'ua jepnim dokumentet që ishin
5 sjellë. Në fillim nuk donim t'ua jepnim dokumentet, ashtu siç
6 ishim pajtuar me vendimin e përbashkët të këshillit drejtues,
7 siç përmendet në paragrafin 13 më lartë.

8 Fatoni pastaj kontaktoi me Hysniun, për ta pyetur nëse
9 duhej t'ja jepnim dokumentet ZPS-së. Hsyniu ishte në pushime
10 në Shqipëri aso kohe. Ai u pajtua që ne t'ja jepnim dokumentet
11 ZPS-së. Atëherë e informuam edhe Nasimin, pastaj ja dorëzuan
12 dokumentet ZPS-së sipas udhëzimit të Hysniut. Sa e di unë, nuk
13 kemi pasur këshilla juridike në kohën e dorëzimit. Menjëherë
14 pasi që e kryem dorëzimin, isha i lumtur me atë që kishte
15 ndodhur. U largova nga zyrat e OVL-së dhe u ktheva në shtëpi.

16 Sa e di unë Tom Gashi vepron si avokat zyrtar i OVL-së. E
17 di se Hysniu dhe Nasimi kishin folur përpara me Tom Gashin për
18 t'i marrë këshilla.

19 Në të vërtetë, ende kurrë nuk i kam lexuar dokumentet
20 meqenëse nuk kam qenë i interesuar për to.

21 Unë në Hagë kam ardhur vetëm për të dhënë dëshminë.

22 I nderuar Gjykatës, kjo është përmbajtja e deklaratës të
23 cilën kërkoj të pranohen në provat e gjykimit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
25 kundërshtim?

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Përveç paragrafëve që ju
2 përmendëm, jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ka nga z.
4 Worboys? Jo, në rregull.

5 Zonja sekretare, caktoni një numër.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i caktojmë numrin
7 1D7.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
9 [mikrofoni çaktivzuar].

10 Trupi Gjykses e pranon në provat gjykesse deklaratën e
11 zotit Marashi, në përputhje me Rregullën 154 të Rregullores,
12 me përjashtim të paragrafëve 22-24 dhe 26-28, siç është
13 kërkuar nga ZPS-ja. Trupi Gjykses vëren se deklarata është me
14 lidhje dhe ka vlerë provuese, duke qenë se flet për veprime të
15 të akuzuarve në lidhje me akuzat.

16 Gjithashtu zoti Marashi është i pranishëm në sallë, është
17 në dispozicion për kundër pyetje dhe për pyetje nga Trupi
18 Gjykses.

19 Ai gjithashtu ka vërtetuar se deklarata me shkrim
20 reflekton me saktësi atë që ai do të thoshte në Gjykatë dhe
21 Trupi Gjykses e pranon për këtë arsye këtë deklaratë, me
22 klasifikimin si publike.

23 Ka ndonjë pyetje tjetër, Z. Bowden?

24 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera.

25 Py. Zoti Marashi, siç e dini, Prokuroria do t'ju bëjë pyetje

1 të tjera. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

3 Worboys?

4 Z. WORBOYS: [Përkthim] S'ka pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Z.

6 Halling? Më falni, Znj. Bolici?

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Pa problem, kam disa pyetje.

8 Pyetje të palës tjetër nga Znj. Bolici:

9 Py. Zoti Marashi, mirëdita.

10 Pë. Mirëdita.

11 Py. Më quajnë Valeria Bolici. Do t'ju bëj disa pyetje.

12 Në paragrafin 10 të deklaratës suaj thoni se dhatë
13 dorëheqjen në vitin 2019, si anëtar i kryesisë së OVL UÇK-së.
14 Në paragrafin 11 të deklaratës suaj, deklaroni se jeni ende
15 anëtar. Pra në paragrafin 10 thoni që jeni anëtar i këshillit
16 drejtues.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
18 ndjesë zonja Bilici, është paragrafi 12.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë është paragrafi 12
20 në versionin në anglisht. A mund të na shpjegoni se çfarë
21 është këshilli drejtues i OVL UÇK-së?

22 Pë. I nderuar Gjykatës, Organizata e Veteranëve e ka
23 organizimin piramidial. Domethënë nga kupola, shtrihet deri
24 edhe nëpër degë dhe seksionet që është edhe më gjerë. Për sa i
25 përket organizimit, në qendër, përveç kryesisë së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 84

1 ngushtë, ekziston këshilli drejtues. Këshilli drejtues i ka 61
2 anëtarë. Dhe kjo është e cektë edhe në deklaratë.

3 Dhe përderisa u kërku që të hiqen pikat nga deklarata
4 ime, mbetem pak borxh të shpjegoj edhe disa gjëra nëse më
5 lejohet, sa i përket organizimit të Organizatës së Veteranëve
6 të Luftës dhe punës që bënte Organizata e Veteranëve të
7 Luftës. Kjo është mirë edhe për ju ta dini. Vetë jam si pjesë
8 e organizatës për 20 vite, duke mos u shkëputur asnjëherë nga
9 veprimi por detyrat dhe funksionet në Organizatën e Veteranëve
10 nuk janë të dhunshme, nuk merremi me dhunë. Vetë Organizata
11 është bashkimi i lirë dhe i vullnetshëm i veteranëve të
12 luftës. Kështu që kam të drejtë të jap tërheqje --
13 Py. Zoti Marashi --

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
15 presim hë për hë. Hë për hë përgjigjuni vetëm pyetjes së
16 zonjës Prokurore. Pastaj nëse avokati i Mbrojtjes ka ndonjë
17 gjë për të shtuar apo për t'ju bërë pyetje, do t'jua bëjë ato
18 pyetje. Hë për hë përgjigjuni pyetjes së zonjës Bolici.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

20 Py. Zoti Marashi, më intereson që ta kuptoj më mirë
21 strukturën. Shpjegoni se ka një këshill drejtues të përbërë
22 nga 61 anëtarë. Kështu?

23 Pë. Po.

24 Py. Po kryesia ndryshon nga këshilli drejtues? Është tjetër?

25 Pë. Nuk mundet me kanë anëtar i kryesisë nëse mos me qenë

1 njëherësh edhe anëtar i këshillit drejtues. Këshilli drejtues
2 është organi më i lartë i Organizatës së Veteranëve. Kryesia e
3 ngushtë ka angazhime ma shumë, ka punë ma shumë, normal që
4 përgjegjësitë ndahen përmes këshillit drejtues. Për atë arsye
5 edhe ekziston edhe kryetari, nënkryetari, sekretari, dhe
6 anëtarët e tjerët është kryesisë të cilët janë të angazhuar në
7 punët e përditshme të organizatës.

8 Py. Zoti Marashi, na thatë që organizata ka formë piramidale,
9 është si piramidë, duke filluar nga kupola e piramidës. Na
10 thatë që ka një kryesi. Nga sa anëtarë përbëhet kryesia?

11 Pë. Kryesia varet -- kryesisht në bazë të kuvendit të fundit
12 që kemi mbajt, varet nga vullneti i kryetarit, nënkryetarit
13 dhe ata mund të vendosin. Shkon me 6, me 12, deri në 22-23.

14 Py. Në rregull. Sa anëtarë të kryesisë ishin në shtator të
15 vitit 2020?

16 Pë. Në shtator të vitit 2020 nuk kam qenë anëtar i kryesisë.

17 Py. A e dini se sa anëtarë kishte kryesia në shtator të vitit
18 2020?

19 Pë. Di sa anëtarë i ka këshilli drejtues. Nuk e di sa i ka
20 kryesia.

21 Py. Në rregull. Në shtator të vitit 2020, krahas Hysni
22 Gucatit, Nasim Haradinajt, dhe Faton Klinakut, ju kujtohet se
23 kush tjetër ka qenë anëtar i kryesisë?

24 Pë. Edhe një herë pyetjen se nuk e kuptova.

25 Py. Po. Në shtator të vitit 2020, Hysni Gucati, Nasim

1 Haradinaj dhe Faton Klinaku, a ishin anëtarë të kryesisë?

2 Pë. Po këta janë anëtarë të kryesisë.

3 Py. Po, dhe a ju kujtohet nëse në shtator të vitit 2020 ka
4 pasur edhe anëtarë të tjerë të kryesisë? Kush tjetër ka qenë
5 anëtar i kryesisë asokohe?

6 Pë. Unë e shpjegova, fare mirë, në këtë kohë nuk kam qenë
7 anëtar i kryesisë dhe nuk kam marrë pjesë në mbledhjet të
8 kryesisë por kam marrë pjesë në mbledhjet e këshillit
9 drejtues.

10 Py. E di. Zoti Marashi, ju pyes nëse e dinit, nëse e dini.
11 Nëse e dini, nëse në shtator të vitit 2020 ka pasur apo jo
12 anëtarë të tjerë të kryesisë. Është shumë e qartë që ju vetë
13 nuk keni qenë anëtar, po a keni dijeni të ketë pasur edhe
14 anëtarë të tjerë të kryesisë, krahas Gucatit, Haradinajt dhe
15 Klinakut?

16 Pë. Me siguri që ka por me emra nuk më kujtohen.

17 Py. E kuptoj. Të kalojmë tani nga kryesia, hallka tjetër
18 është këshilli drejtues. Kështu? Që përbëhet nga 61 anëtarë.

19 Pë. Po.

20 Py. Dhe pastaj më tutje më poshtë, cili është niveli tjetër i
21 organizimit?

22 Pë. Nuk ka në seli qendrore nivel tjetër të organizimit. Ka
23 seksione, departamente. Po jo, nuk ka. Nuk ka. Organizimi, e
24 ceka në fillim, fillon nga nën-degët nëpër komuna anekënd
25 Kosovës, bartet në komuna. Nga komuna delegohen delegatët në

1 selinë qendrore dhe zgjedhjet e këshillit drejtues, kryesisë,
2 kryetari i kryesisë, dhe kështu me radhë.

3 Py. E kuptova. Për të qen[është të qartë, kur thoni në
4 paragrafin 10, përmendni aty që në vitin 2019 "hoqa dorë nga
5 kryesia" e keni fjalën për kryesinë? Se në anglisht përdoren
6 të ndryshme.

7 Pë. Këtu duhet ta sqaroj, nuk është viti 2019. Është bërë
8 gabim, po është viti 2017. Është koha kur Hysni Gucati është
9 zgjedh kryetar. Nasimi ka qenë nënkryetar. Në mbledhjen e parë
10 unë kam dhanë dorëheqje e cila është pranuar me shumicë të
11 votave.

12 Py. Pra, dëshironi që t'i bëni korigjim paragrafit 10 të
13 deklaratës suaj se është e pasaktë. Kështu?

14 Pë. Vetëm viti, viti 2017 jo 2019. Është koha kur është
15 zgjedhur kryetar Hysni Guicati.

16 Më vjen keq edhe prej Mbrojtjes, por është bërë lapsus.

17 Py. E kuptoj. Zoti Marashi, a e dini sa anëtarë ka Organizata
18 e Veteranëve të Luftës së UÇK-së?

19 Pë. Si mendoni sa anëtarë i ka? Veteranë?

20 Py. Është një organizatë e cila ka anëtarë, e kam kuptuar
21 qartë?

22 Pë. Po.

23 Py. A e dini se sa anëtarë, se sa persona janë anëtarë të
24 kësaj organizate?

25 Pë. Përafërsisht e di. Muj me pas ndonjë gabim -- po e di.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 88

1 Py. Mund të na jepni një shifër të përafërt, afërsisht sa
2 anëtarë ka OVL UÇK-ja?

3 Pë. Më vjen shumë keq, jo.

4 Py. Po të themi, dhjetëra? Qindra? Mijëra? Sa?

5 Pë. Nuk du me -- kjo është e drejta ime, nuk mund ta jap, nuk
6 është edhe sekret aq, por për shkak se ju i keni bastisur
7 zyrat, keni konfisku një numër të madh materialesh nga zyrat e
8 OVL-së, pa ndonjë procedurë ose pa ndonjë procesverbal, ju me
9 siguri e dini sa është numri i përafërt dhe unë nuk du me
10 spekul.

11 Py. Zoti Marashi, ju lutem përgjigjuni pyetjes. A jeni në
12 gjendje të thoni se pak a shumë, pra sa anëtarë mund të jenë.
13 Mund të jenë qindra anëtarë? Mijëra anëtarë? Dhjetë mijë
14 anëtarë? Pakë a shumë.

15 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kundërshtoj. I
16 është bërë kjo pyetje tre herë. Përgjigja e fundit ishte se
17 nuk dëshiron të spekulojë dhe jam i sigurt që Prokurorja nuk
18 ka nevojë të spekulojë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Nuk duam
20 të spekuloni, por nëse nuk e dini thoni nuk e di.

21 DËSHMITARI: Po edhe zoti Gjykatës, nuk jam obliguar ta
22 jap këtë numër. Më vjen shumë keq. Është sekretaria e cila
23 merret me shënimet e përpikta dhe shënime të çdo anëtari të
24 Organizatës së Veteranëve. Ajo nuk është punë e imja.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 89

1 Marashi, ju pyetëm për një vlerësim të përafërt. Dini apo nuk
2 e dini.

3 DËSHMITARI: Është mbi 10,000.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë
5 ju jap një urdhër që të jepni përgjigje.

6 DËSHMITARI: Është mbi 10,000.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

10 Py. Faleminderit, Zoti Marashi. Dëshiroj të kalojmë në
11 paragrafin 17 të deklaratës suaj, ku përmendni takimin që keni
12 bërë me hetuesit e ZPS-së në rastin e ardhjes për herë të parë
13 në OVL UÇK, kur janë sekuestruar këto, kur janë marrë nga
14 përfaqësuesit e ZPS-së. Këtu thoni që i thamë njërit prej
15 hetuesve:

16 "A e dini ku jeni këtu? Jeni në zyrat e OVL UÇK-së. Ne
17 ofrojmë siguri".

18 Zoti Marashi, e kishit fjalën që hetuesi i ZPS-së nuk
19 kishte autoritet brenda mjediseve të OVL UÇK-së?

20 Pë. Dua ta shpjegoj, zoti Gjykatës, detale se si ka qenë
21 puna.

22 Py. Dëshiroj, zoti Marashi, t'i përgjigjeni kësaj pyetje,
23 pastaj, nëse është e nevojshme mund të kalojmë me pjesë tjetër
24 të ngjarjeve. Me këtë fjali, çfarë keni dashur të thoni?

25 Pë. Mënyra dhe këtë që ja kemi thënë ka pasur një arsye përse

1 ja kemi thënë. Se ishte sjellja --

2 Py. Ç'doni të thoni me këtë fjali?

3 Pë. Sepse mënyra se si janë paraqitur dhe si kanë hyrë në
4 zyrat e OVL-së, i ka tejkalu kompetencat e tyre dhe mënyrën e
5 sjelljes së tyre si zyrtarë. Se s'e ka caktu një ultimatum,
6 duke na thënë mua dhe Fatonit që ishim në kafene: "keni dy
7 minuta që të vini në zyrë". Dhe kjo normal që na ka irritu.
8 Edhe ju kemi drejtu se "se a e dini që ku jeni?". Nuk
9 përputhej sjellja me një zyrtar i cili ka ardhur në mënyrë të
10 mirësjellshme që të kërkonte një dokumente ose një shërbim.
11 Por erdhi në formë urdhri, pa tregu asnjë dokument. Ishte veti
12 i dytë dhe dy përkthyes i kishte me vete.

13 Py. Zoti Marashi, kur i thatë hetuesit "A e dini ku jeni?
14 Jeni në zyrat e OVL UÇK-së" a keni dashur të thoni që hetuesit
15 e ZPS-së nuk kishin autoritet në Organizatë të Veteranëve të
16 Luftës së UÇK-së?

17 Pë. Normal që nuk kishin, sepse e tërë opinioni i Kosovës,
18 por edhe më gjerë, e di që Organizata e Veteranëve ka qenë
19 kundër kësaj Gjykate dhe normal që nuk ka bashkëpunim me ta.
20 Prandaj edhe po them, duke ardhur pas asnjë përfaqësues të
21 shtetit të Kosovës këtu, në zyrat tona, duke anashkaluar
22 Prokurorinë e Kosovës, policinë e Kosovës, normal që ne kemi
23 garantu sigurinë në zyra për çdo njërin. Nuk ka pasur nevojë
24 kurrkush me u siguru.

25 Py. U keni thënë hetueseve se nuk i njohim Dhomat e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 91

1 Specializuara të Kosovës në atë rast?

2 Pë. Po.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse
4 dëshironi Trupi Gjykses mund ta ndalojmë këtu për pauzën.
5 ndalojmë këtu për pauzën.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Edhe sa
7 pyetje të tjera keni?

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk kemi më shumë se 15 minuta.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
10 [Mikrofoni çaktivizuar].

11 Nuk e di nëse përkthyesit mund të vazhdojnë edhe 15
12 minuta të tjera.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ose gjysmë ore.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ah. Më
15 shumë, atëherë do bëjmë tani pauzën për drekë.

16 Do të rikthehemi në orën 14.30.

17 Zoti Marashi, nuk duhet të bisedoni me askënd për
18 dëshminë në këtë sallë jashtë sallës.

19 Tani do t'ju shoqërojnë për të dalë nga salla. Ju lutem
20 të riktheheni në orën 14.30.

21 [Dëshmitari largohet]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë e
23 ndërpresim seancën -- apo keni diçka?

24 Z. BOWDEN: [Përkthim] Sa i takon administrimit të pjesës
25 tjetër të pasdrekes, kemi edhe një dëshmitar tjetër që mund të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 92

1 thirret.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Do të
3 ketë kohë.

4 Z. BOWDEN: [Përkthim] Mbase për pjesën kryesore, pra për
5 pyetje që bën pala thirrëse. Mbase pastaj nuk e dimë se si do
6 të veprojë. A do ta kalojmë, do ta lemë për nesër, do
7 vazhdojmë nesër --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Do
9 shikojmë se si do të ecim sot.

10 Tani ndërpresim seancën deri në orën 14.32 minuta.

11 --- Pushimi i drekës filloi në orën 13.02

12 --- Seanca rifillon në orën 14.30

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
14 Sekretare ju lutem shoqëroheni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
17 Bolici mund të vazhdoni me pyetjet.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.
19 Py. Zoti Marashi, mirëdita. Përpara pushimit ne po flisnim
20 për ngjarjet e 8 shtatorit të 2020-s në OVL-UÇK, pra në
21 ambientet e OVL-UÇK-së. Ju na thatë që ti ose ju edhe Faton
22 Klinaku i keni thënë hetuesve të ZPS-së që nuk e njihni këtë
23 Gjykatë, a është e saktë kjo?

24 Pë. Po, e saktë.

25 Py. Zoti Marashi, a ishin hetuesit aty për t'ju ofruar një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 93

1 urdhër, për t'ju dhënë, për t'ju dorëzuar një urdhër të
2 gjykatësit të Gjykatave të Specializuara të Kosovës, a është e
3 saktë kjo?

4 Pë. Nuk është e saktë për fillim. Të mos e anashkalojmë
5 hyrjen e tyre ne objektet e restorantit. Nuk kanë prezentu
6 asnjë dokument prezentimi se kush janë, vetëm gojarisht. Edhe
7 thashë e ka thonë, "i keni dy minuta të hyni në zyrë". Kjo e
8 ka irritu fillimin e takimit.

9 Py. Zoti Marashi, hetuesit e ZPS-së që ishin të pranishëm
10 atje, a kishin ardhur që të dorëzonin një urdhër të një
11 gjykatësi të Dhomave të Specializuara të Kosovës?

12 Pë. Pasi që është relaksuar situata dhe ulur ai që qëndronte
13 në këmbë dhe mbante maskë dhe pastaj e kanë dorëzuar urdhrin.

14 Py. Faleminderit. Ju në paragrafin 19 të deklaratës tuaj
15 thoni se:

16 "Në fillim nuk donim t'ua jepnim dokumentet ashtu siç
17 ishim pajtuar në vendimin e përbashkët të këshillit drejtues".
18 A është e saktë kjo?

19 Pë. Deklarata është e saktë.

20 Py. Pra e kuptoj saktë që në fillim ju nuk donit që të
21 respektonit vendimin e gjykatësit të Dhomave të Specializuara
22 të Kosovës, a është e saktë kjo?

23 Pë. E saktë është dhe po të mos ishte thirrja që bëri me
24 telefon Fatoni dhe kontaktoi kryetarin me siguri që nuk do t'i
25 merrnin.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 94

1 Py. Ju dhe Faton Klinaku e morët në telefon, pra e thirrët

2 zoti Gucati në atë rast. A është e saktë kjo?

3 Pë. Jo unë dhe Fatoni, po e ka thirrë Fatoni.

4 Py. A ishit i pranishëm ju kur u bë thirrja me zoti Gucati?

5 Pë. Po, po.

6 Py. Dhe a e dëgjuat ju se çfarë i tha Faton Klinaku z.

7 Gucati?

8 Pë. Po normal që e kam dëgju, dhoma tri me tri, normal që po.

9 Py. Në rregull. Dhe çfarë i tha z. Klinaku z. Gucati?

10 Pë. Po ju lutem këto detale shumë të imta. Janë ardhë

11 përfaqësuesit e Dhomave Speciale, po kërkojnë dosjet, kaq ka

12 qenë. Dhe Hysi me siguri i ka thonë në telefon që po jepja.

13 Py. Dhe pas telefonatës me zoti Gucati, ju dhe zoti Faton

14 Klinaku ia dorëzuat dosjet hetuesve të ZPS-së, a është kështu?

15 Pë. Po.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua që të shfaqet në ekran

17 dokumenti në listën e dokumenteve të ZPS-së znj. Sekretare,

18 është dokumenti me numër identifikimi ERN 104298-104334 [sipas

19 përkthimit], së bashku me përkthimin përkues në gjuhën

20 angleze. Dua t'ju kërkoj që të kaloni në faqen 104301. Mjafton

21 vetëm figura.

22 Py. Zoti Marashi, a jeni ju këtu në këtë fotografi?

23 Pë. Po, jam. Kjo është shtëpia ime.

24 Py. A është llogaria juaj në Facebook kjo?

25 Pë. Është dhe është publike.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 95

1 Py. A e menaxhoni vetë profilin tuaj në Facebook?

2 Pë. Vetëm unë, askush tjetër.

3 Py. Faleminderit.

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dua të kalojmë në faqen
5 104333 në të dyja versionet, pra në versionin origjinal në
6 shqip dhe në përkthimin në anglisht. Ky është një postim në
7 Facebook me datë 7 shtator 2020.

8 Py. Dhe në profilin tuaj thuhet që:

9 "Pas dosjeve tani e tutje gjykata speciale do të punojë
10 në bazë të deklaratave të dëshmitarëve të mbrojtur publikë".

11 Këtu ju iu referuat ngjarjeve që kishin ndodhur në OVL-
12 UÇK më herët atë ditë?

13 Pë. Nëse është - meqenëse e paske përcjell profilin tim në
14 Facebook, unë zakonisht përpiloj aforizma dhe profilin në
15 Facebook e kam më shumë se 11 vite. Çdo postim i im është
16 publik dhe nganjëherë i rendizoj po në shumicën e rasteve sa i
17 përket qëndrimit për Gjykatën Speciale, Dhomat e Specializuara
18 - qëndrimi i Organizatës së Veteranëve dhe anëtarëve të saj
19 dihet, nuk ka kurrfarë shmangie nga kjo. Plotësisht e kam
20 shkru edhe mendoj se ka të bëjë me gjykatën, jo me dosjet se
21 dosjet s'i kam lexu.

22 Py. Në këtë postim zoti Marashi, a e kishit fjalën për
23 konferencën për shtyp që u organizua në OVL-UÇK më herët atë
24 ditë më datë 7 shtator 2020?

25 Pë. Nuk kam qenë në OVL të UÇK-së më 7 shtator.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 96

1 Py. Zoti Marashi, ju lutem dëgjojeni me kujdes pyetjen dhe
2 përgjigjuni pyetjes që po ju bëj. Pyetja është kjo: Në këtë
3 postim që e keni publikuar në profilin tuaj në Facebook, a e
4 keni fjalën për atë çfarë kishte ndodhur në OVL-UÇK atë ditë,
5 çfarë do të thotë konferencën për shtyp të mbajtur më 7
6 shtator 2020?

7 Pë. Ju lutem këtu nuk përmendet as konferenca për shtyp, as
8 nuk përmendet emri i asnjë dëshmitari, përmendet një qëndrim i
9 imi dhe një mendim i imi sa i përket punës së kësaj Gjykate
10 dhe plotësisht përsëri qëndroj pas kësaj.

11 Py. Kur thoni "pas dosjeve" për çfarë dosjesh e keni fjalën,
12 kur e keni shkruar këtë gjë në profilin tënd në Facebook?

13 Pë. Po kjo ka qenë publike. Kanë qenë të gjitha mediat e
14 Kosovës. Dihet që ka të bëjë me dosjet, të cilat kanë rrjedhur
15 nga ju.

16 Py. Dhe dihej publikisht lidhur me konferencën për shtyp që
17 ishte mbajtur atë ditë, a është e saktë kjo?

18 Pë. Po thashë krejt Kosova e ka ditë.

19 Py. Faleminderit. Dhe a ishit ju i lumtur që deklaratat e
20 dëshmitarëve të mbrojtur u bënë publike atë ditë zoti Marashi?

21 Pë. Jam i lumtur edhe sot jam i lumtur edhe sinqerisht po ju
22 them mënyra e themelimit të Gjykatës në mëse 20 vite jemi të
23 pakënaqur si Organizatë e Veteranëve, personalisht si luftëtar
24 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me mënyrën e trajtimit të
25 ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga të gjitha

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 97

1 misionet që kanë qenë deri më tani në Kosovë, UNMIK, EULEX
2 edhe tash Dhomat e Specializuara. Nuk kam çka me msheh. Është
3 diçka kundra vullnetit tonë edhe qëndrojmë prapa saj. Edhe
4 besoni një mendim të tillë shumica e luftëtarëve, pjesa
5 dërrmuese e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e
6 kanë.

7 Py. A është pikëpamja kjo edhe e Hysni Gucatit dhe e Nasim
8 Haradinajt?

9 Z. BOWDEN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e kundërshtoj
10 se nuk është pjesë e detyrave të këtij dëshmitari që të
11 komentojë qëndrimin e personave të tjerë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vetëm në
13 qoftë se ai e di, d.m.th. ndoshta mund të bëni pyetjen në
14 qoftë se ai e di sesi ndihen dy të akuzuarit për këtë gjë.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

16 Py. Zoti Marashi, a e dini ju në qoftë se i njëjti qëndrim
17 ndahet edhe nga z. Gucati dhe z. Haradinaj apo jo? E kanë edhe
18 këta të dy të njëjtin qëndrim apo jo?

19 Z. BOWDEN: [Përkthim] Pra mbase do të dua që të pyetet në
20 qoftë se ka pasur një diskutim të drejtpërdrejtë me zoti
21 Gucati dhe me zoti Haradinaj. Kjo është një pyetje e padrejtë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

23 Kundërshtojmë kundërshtimin tuaj. Ju lutem dëshmitari t'i
24 përgjigjet pyetjes.

25 DËSHMITARI: E thashë, kur them pjesa dërrmuese e Ushtrisë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 98

1 Çlirimtare, e ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
2 këtu përfshihet kryetari, nënkryetari dhe të gjithë ushtarët e
3 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

4 Publikimi i dosjeve - ju lutem më lejoni ta përfundoj -
5 publikimi këtyre dosjeve, ardhja e këtyre dosjeve ne
6 Organizatën e Veteranëve është çështje që duhet ta brengosë
7 edhe mu, edhe Hysnin, edhe gjithë çka jemi ushtarë të Ushtrisë
8 Çlirimtare të Kosovës, sepse e dimë nga rrjedhin. Anashkalimi
9 i burimit të ktyne është për tu diskutu, është për tu dënu, jo
10 të bëhet [e padëgjueshme] ndaj ushtarëve të Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës. Personalisht duhet kërkuar përgjegjësi
12 nga këto institucione jo nga veteranët e luftës ose Organizata
13 e Veteranëve.

14 Py. Zoti Marashi, ju lutem përgjigjuni pyetjes pa ju shmangur
15 asaj.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua që të kalojmë në faqen
17 104328, të dyja versionet, në versionin anglisht dhe versionin
18 në shqip.

19 Py. Ky është një postim që është publikuar në profilin tuaj
20 në Facebook më 8 shtator 2020. Këtu shkruhet:

21 "Jeta e spiunëve; joshin që të bashkëpunojnë, pastaj i
22 dekonspirojnë dhe më në fund i eliminojnë"!

23 Py. Në këtë postim zoti Marashi, a i drejtohesh dëshmitarëve
24 si spiuna?

25 Pë. Në përgjithësi i drejtohem spiunëve. Edhe dëshmi e jetës

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjtër nga znj. Bolici

Faqe 99

1 së tyre dhe veprimet të tyre është publikimi i dosjeve,
2 nxjerrja e dosjeve nga ana e Prokurorisë. Nëse kanë qenë
3 njerëzit dëshmitarë të mbrojtun, si u bo e mundshëm që këta të
4 publikohen, të dalin nga ju?! Është shumë e thjeshtë, kjo
5 është jeta e atyre. Unë s'kam cek emra, e kam thënë në
6 përgjithësi për spiunët. Ndoshta ka të bëjë edhe me spiunët e
7 kësaj Gjykate, por në përgjithësi spiunët edhe nga traditat
8 edhe nga bisedat e vjetra edhe nga historia e dëshmon që jeta
9 e tyre është e tillë.

10 Py. Zoti Marashi, të lutem përgjigjuni pyetjes pa iu
11 shmangur. Pra a e kuptoj drejtë se kur thoni "spiuna" e keni
12 fjalën për dëshmitarët? A është e saktë kjo?

13 Pë. Nuk po them dëshmitarët edhe lexoni statusin ju lutem,
14 kuptoni statusin. Ka të bëjë me spiunët në përgjithësi. Edhe
15 në luftën e parë, e në luftën e dytë botërore dhe në gjitha
16 luftërat, spiunët në fund janë të dekonspiruar nga ata që kanë
17 punuar për ta. Në këtë rast, e kemi rastin konkret, publikimi
18 i dosjeve nga ana e Prokurorisë Speciale, Dhomave Speciale.
19 Është dokumenti që nuk mundemi me e shmang. Ne muj të bëjmë
20 lojna fjalëve këtu, po faji, fajtori kryesor i publikimit për
21 jetën e spiunëve janë pikërisht punëdhënësit e tyre. Dhe nuk
22 është obligimi joni të mbrojmë askënd.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj të kalojmë në faqen
24 104301 në të dyja versionet, në versionin në gjuhën angleze
25 dhe në versionin në gjuhën shqipe.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 100

1 Py. Ky është një postim i datës 21 shtator 2020. Në të
2 shkruani:

3 "Përshëndetje. Në pritje të gjërave të reja, veçanërisht
4 nga Rrufeja 3".

5 A e dinit ju zoti Marashi që do të vinte Rrufeja 3 në OVL
6 UÇK ditën e nesërme?

7 Pë. Jo.

8 Py. A shpresonit ju që Rrufeja 3 të vinte në OVL-UÇK në ditët
9 në vijim?

10 Pë. Sepse ishte e paralajmëruar nga personi që e kishte
11 sjellë në zyrë dy herët e para dhe mezi prisnim pse jo.

12 Py. A uronit që Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj të
13 shpërndanin më shumë informacion, më shumë dokumente ndërkohë
14 që pritej konferenca tjetër e radhës për shtyp?

15 Pë. Nuk po e kuptoj pyetjen. Si të shpërndanin Hysniu dhe
16 Nasimi një diçka që s'ka ardhë akoma?

17 Py. A shpresonit, a uronit që të vinin më shumë dokumente në
18 OVL UÇK dhe ajo çfarë kishte ndodhur në fakt në dy rastet e
19 mëparshme më 7 dhe më 16 shtator të ndodhte sërish?

20 Pë. I nderuar Gjykatës, që nga dita e parë që kanë ardhur
21 dosjet në Organizatën e Veteranëve dhe që ka të bëjë me
22 komprometimin e këtyre Dhomave Speciale normal që ka qenë e
23 mirëpritur për ne. Unë për atë arsye nuk isha dakord
24 kundërshtimi se pse u hoq pika 22 kur ishte të bënte me
25 deklaratën time të mëparshme? Ku e ka burimin ky kundërshtimi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 101

1 jonë ndaj Dhomave Speciale? Normal që jam gëzuar edhe më ka
2 ardhur mirë.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dua të shfaqet faqja 104311
4 në versionin në shqip dhe në versionin në anglisht.

5 Py. Ky postim është publikuar në faqen e Facebook-ut tuajën
6 më datë 29 shtator 2020. Në të lexohet:

7 "A u bindët ju spiunë e servila se e kemi vrarë frikën me
8 kohë. Qëndrimi i Nasim Haradinaj është qëndrimi i shumicës së
9 luftëtarëve të lirisë"!

10 Kujt i drejtohesh këtu kur thua "spiunë" dhe "servila"?

11 Pë. Kjo është çështje e jemja. Unë iu kam drejtu në opinion

12 publik. Qëndrimi i Nasimit është shembull i qëndrimit i çdo

13 luftëtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe normal si

14 njeri i sakrificës me familje që ka dhënë për këtë liri të

15 Kosovës është shembull edhe çdo qëndrim që e thotë sa i përket

16 luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe çështjes së

17 kombit, normal që çdo ushtar i Ushtrisë Çlirimtare pajtohet me

18 Nasimin. Pajtohem edhe vetë.

19 Py. Pra ju e mbështesni Nasim Haradinajn apo jo?

20 Pë. E mbështes zotin Nasim Haradinaj, e kam bashkëluftëtar.

21 Kemi qenë bashkë edhe në vijë të frontit edhe njihem që nga

22 rinia e hershme. E posaçërisht për babën e tijna që e kam pasë

23 idol.

24 Py. Faleminderit z. Marashi.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk ka pyetje të tjera

1 Prokuroria.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

3 Faleminderit znj. Bolici.

4 Z. Bowden.

5 Z. BOWDEN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, si rrjedhojë e
6 pyetjeve të Prokurorisë nuk e di në qoftë se do më lejoni të
7 bëj një pyetje sqaruese.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

9 Pyetje vijuese nga z. Bowden:

10 Py. Zoti Marashi, në paragrafin 9 dhe 10 të deklaratës tuaj,
11 ju keni deklaruar kohën që keni qenë anëtar i komitetit
12 drejtues në vitin 2009 deri në vitin 2019. Dhe ju thoni që
13 mbase mund ta keni dhënë gabim. Domethënë nuk keni dhënë
14 dorëheqjen në 2019-n po ndoshta në 2017-në; a thatë këtë gjë?
15 Pë. Po.

16 Py. A ishte fakt që në fakt z. Gucati është emëruar më 15
17 tetor 2017? A e mbani mend?

18 Pë. Po.

19 Py. Dhe në atë kohë a keni mbetur anëtar i komitetit në kohën
20 e emërimit të tij?

21 Pë. Këtu më së pari po i drejtohem përkthyesit, nuk ekziston
22 "komitet", këtu se po e shoh edhe në media e kam pa, nuk ka
23 komitet në Organizatën e Veteranëve, ekziston këshilli
24 drejtues. Pasi që u zgjedh zoti Hysni, kryetar, mbledhjen e
25 parë të kryesisë unë e kam dhënë dorëheqjen, pas zgjedhjes së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Pren Marashi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Bowden

Faqe 103

1 kryetarit dhe kryesisë në mbledhjen e parë unë kam dhënë
2 dorëheqje dhe me një votë, për një votë është miratu.
3 Py. E kuptoj. Pra në kohën ne zgjedhjes së tij, ju ishit
4 anëtar, por pak kohë më pastaj juve dhatë dorëheqjen kjo
5 ishte?

6 Pë. Po.

7 Py. Mirë faleminderit.

8 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk kam asgjë tjetër. S'kam pyetje
9 të tjera zoti Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.

11 Worboys.

12 Z. WORBOYS: Jo nuk kam pyetje të tjera.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk ka
14 pyetje nga z. Worboys.

15 Nuk e di në qoftë se anëtarët e Trupit Gjykses kanë
16 ndonjë pyetje për dëshmitarin. Nuk ka pyetje nga anëtarët e
17 Trupit Gjykses.

18 Z. Marashi, ky është fundi i dëshmisë tuaj. Jeni i lirë
19 të largoheni tani. Ju urojmë ditë të mbarë.

20 DËSHMITARI: Faleminderit.

21 [Dëshmitari largohet]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë
23 përpara sesa të vijojmë dhe të thërrasim dëshmitarin tjetër,
24 dua të sqaroj diçka për procesverbalin.

25 Klasifikimi i provës materiale të pranuar 1D5 dhe

1 1D6 do të jenë publike.

2 Znj. Sekretare, mund të shoqëroni zoti Kryeziu në sallën
3 e gjyqit.

4 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund ta
6 heqni maskën.

7 Zoti Kryeziu, më dëgjon? Na dëgjon tani zoti Kryeziu.

8 DËSHMITARI: Po, dëgjoj.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
10 zoti Kryeziu. A po e them siç duhet mbiemrin tuaj? Kryeziu e
11 keni?

12 DËSHMITARI: Po, Kryeziu.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
14 Kryeziu, zonja Sekretare tani do t'ju japë tekstin e
15 deklaratës solemne që duhet ta lexoni në përputhje me
16 rregulloren tonë. Ju lutem lexojeni me zë tekstin që keni
17 përpara.

18 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
19 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
20 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
21 nuk do ta mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

22 DËSHMITARI: METUSH KRYEZIU

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

24 Faleminderit zoti Kryeziu. Mund të uleni.

25 Z. Kryeziu, do dëgjojmë dëshminë tuaj sot. Siç mund ta

1 dini - nuk e di kush do t'i bëjë pyetje zoti Kryeziu. Zoti
2 Bowden?

3 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirë
5 atëherë z. Bowden, do ju bëjë disa pyetje fillimisht dhe që
6 kanë të bëjnë me deklaratat tuaja. Më pas ne do të bëjmë një
7 diskutim të shkurtër lidhur me deklaratën tuaj dhe pasi ta
8 kemi përfunduar këtë diskutim, pjesa e pranuar e deklaratës
9 tuaj do të regjistrohet për procesverbal.

10 Zoti Bowden do t'ju bëjë pyetje në qoftë se ka. Më pas e
11 ka radhën avokati i zoti Haradinaj, i cili mund të bëjë disa
12 pyetje. Pas tij e ka radhën Prokuroria për të bërë pyetje edhe
13 anëtarë të Trupit Gjykes mund t'ju bëjnë pyetje ju.

14 Zoti Bowden vlerëson që mund t'i duhet vetëm 15 minuta
15 për të përfunduar me deklaratën tuaj, ndërkohë që palët e
16 tjera pastaj mund të kenë disa minuta më tej, ca kohë më tepër
17 për t'ju bërë pyetje lidhur me deklaratën tuaj. Ndërkohë që
18 edhe anëtarët e Trupit Gjykes n.q.s. përmbushen kushtet e
19 nevojshme mund t'ju bëjnë disa pyetje.

20 Ju lutem mundohuni që pyetjet t'i përgjigjeni në mënyrë
21 të qartë. Mundohuni që të përdorni fjali të qarta. N.q.s. nuk
22 e kuptoni një pyetje, na kërkoni që ta përsërisim atë ose ta
23 shprehim në mënyrë ndryshe. Ju lutem po ashtu na tregoni bazën
24 e njohurive të fakteve, rrethanave për të cilat do të pyeteni.

25 Ju lutem flisni para mikrofonit dhe prisni pesë sekonda

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 106

1 përpara sesa t'i përgjigjeni një pyetje dhe ju lutem flisni me
2 një ritëm të ngadaltë në mënyrë që mund t'ju ndjekin
3 përkthyesit.

4 Ndërkohë që jepni dëshmi përpara Gjykatës nuk lejoheni që
5 të diskutoni me askënd me përmbajtjen e deklaratës tuaj.

6 N.q.s. dikush ju bën pyetje lidhur me deklaratën tuaj jashtë
7 Gjykatës, ju lutem na e tregoni këtë gjë.

8 Zoti Bowden, si me dëshmitarët e mëparshëm, ju lutem
9 pyesni fillimisht n.q.s. deklaratata e tij reflekton në mënyrë
10 të saktë ato çfarë do të thotë këtu dhe pastaj do të vazhdojmë
11 me pranueshmërinë e deklaratës dhe do vijojmë me procedurën
12 siç u shpjegua më sipër.

13 Fjalën e keni ju z. Bowden.

14 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk e di n.q.s. mund t'i japim një kopje
15 të deklaratës dëshmitarit.

16 Pyetje nga z. Bowden:

17 Py. Zoti Kryeziu.

18 Pë. Mirëdita.

19 Py. Ju lutem a na e konfirmoni dot emrin tuaj të plotë?

20 Pë. Unë quhem Metush Kryeziu, i lindur më 14 maj 1965, në një
21 fshat Bubavec, Komuna e Malishevës.

22 Py. Faleminderit. Përpara keni deklaratën e dëshmitarit. Ju
23 lutem a mund t'i hidhni një sy kësaj deklarate.

24 Z. BOWDEN: [Përkthim] Znj. Sekretare, nuk e di n.q.s.

25 mund të shfaqni versionin në anglisht dhe në shqip të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 107

1 deklaratave dhe ju lutem hidhini një sy faqes së fundit të
2 deklaratës. Le të shohim faqen e fundit të deklaratës.
3 Py. Në deklaratën që keni përpara - ju lutem kaloni në faqen
4 e fundit në deklaratën që keni përpara. Do të shihni një emër
5 dhe një nënshkrim. A mund të konfirmoni që është emri dhe
6 nënshkrimi juaj?

7 Pë. Po, ky është emri i plotë i jem dhe nënshkrimi jem.

8 Py. Dhe data e këtij dokumenti është data 6 shtator 2021?

9 Pë. Po, 6 shtator 2021.

10 Py. A mund të konfirmoni që e keni parë dhe përpara këtë
11 deklaratë?

12 Pë. Po, e kam pa dhe përpara.

13 Py. Dhe keni pasur mundësi që ta lexoni përmbajtjen?

14 Pë. Po gjithsesi.

15 Py. Dhe përmbajtja e kësaj deklarate është e vërtetë?

16 Pë. Kjo çka qëndron këtu është ajo që e kam thanë dhe është e
17 vërtetë.

18 Py. Dhe konfirmoni se deklarata pasqyron dëshmitë që ju do
19 t'ia kishit dhënë kësaj Gjykate?

20 Pë. Edhe njëherë si ka mundësi, dëgjuset.

21 Py. Mund të konfirmoni të pohoni se përmbajtja e deklaratës
22 suaj është dëshmia, të cilën do të dëshironit t'ia jepnit
23 Gjykatës?

24 Pë. Po, kjo është dëshmia të cilën tash e jap.

25 Z. BOWDEN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 108

1 Përmbajtja e kësaj dëshmie është ajo që Mbrojtja kërkon që të
2 pranohet në provat materiale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

4 Faleminderit z. Bowden.

5 Vë re se ZPS-ja kundërshton dy paragrafë. Ju lutem
6 Prokurorisë të thotë cilat janë arsyet dhe cilët janë
7 paragrafët për procesverbalin.

8 Z. PACE: [Përkthim] Po, paragrafët që kemi kundërshtim të
9 pranohen janë paragrafët 19 dhe 20 të kësaj deklarate. Arsyet
10 janë njësoj si ato që kemi thënë përpara, në veçanti që ajo
11 përmban opinione të papërshtatshme që nuk mbështeten në fakte
12 dhe s'kanë lidhje me akuzat e ngritura kundër të akuzuarve.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

14 Faleminderit z. Pace.

15 Z. Worboys, keni ndonjë kundërshtim?

16 Z. WORBOYS: [Përkthim] Mbajmë të njëjtin qëndrim. Mbajmë
17 të njëjtin qëndrim si edhe për deklaratat e mëparshme.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem
19 caktojini një numër dokumentit.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo deklaratë do të
21 marrë numrin 1D8.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kërkoj
23 ndjesë, 1D8?

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës
25 1D8.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 PËRKTHYESI: [nuk ka mikrofon].

4 Z. Bowden, mund të lexoni deklaratën pa paragrafët e
5 përjashtuar.

6 Z. BOWDEN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

7 Kjo deklaratë lexon kështu:

8 Unë, Metush Kryeziu do të them si në vijim.

9 Jam lindur në Bubavec, në Komunën e Malishevës, Kosovë. I
10 kam gjashtë fëmijë, tre djem dhe tri vajza. Aktualisht jam i
11 punësuar si ekonomist. Punoj në një kompani të quajtur Eko-
12 Regjioni, e cila merret me menaxhimin e mbeturinave. Punoj aty
13 prej vitit 2013. Në moshën e hershme jam shkolluar në shkollën
14 lokale në zonën e Kievës të Kosovës. Jam rekrutuar në Ushtrinë
15 Jugosllave për ta kryer shërbimin ushtarak prej vitit 1983
16 deri në vitin 1984. Pastaj kam shkuar në shkollën ekonomike në
17 Pejë të Kosovës. Në 1987, e kam kryer shkollimin.

18 Ne fund të viteve 80-të, kam punuar në bujqësi dhe u bëra
19 anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe u përfshiva
20 në aktivitete të cilat i zhvillova deri në vitin 1998.

21 Për shkak të shtypjes me të cilën u përballa në të '90-tat kjo
22 më shtyri të bëhem anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
23 (UÇK). Ju bashkova UÇK-së më 20 mars 1998 deri më 19 shtator
24 1999 kur ndodhi dhe transformimi.

25 Në tetor të vitit 1998 u bëra komandant toge. Në dhjetor

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 110

1 1998 u bëra komandant i batalionit. Prej vitit 1999 deri në
2 vitin 2008, kam qenë shef brigade në TMK.

3 Në 2013, u punësova në ndërmarrje publike në fushën e
4 higjienës publike. Më 2016, kandidova për kryetar të degës
5 sime lokale të OVL-së për t'i shërbyer më mirë të drejtave të
6 veteranëve, të cilat ishin shkelur.

7 U bëra kryetar në vitin 2016 dhe ende jam kryetar. Jam
8 kryetar i degës së OVL-së në Malishevë. Jam po ashtu anëtar i
9 23 anëtarëve të kryesisë së OVL-së. Kjo kryesi përbëhet prej
10 të gjithë pjesëtarëve kryesorë të OVL-UÇK-së, përfshirë
11 kryesinë e zyrës kryesore, Hysni Gucatin, kryetar; Nasim
12 Haradinajn, zëvendëskryetar; Faton Klinakun, sekretar; dhe
13 pjesën tjetër të kryesisë.

14 Nga mediat kisha kuptuar që në zyrat e OVL-së ishin
15 sjellë tri herë dokumente në data të ndryshme. Storit u
16 shfaqën në RTK, transmetuesi publik, në KTV dhe në të gjitha
17 mediat e tjera po ashtu.

18 Vendimi që të bëheshin publike dokumentet e sjella ishte
19 vendim kolektiv, të cilin e mori kryesia e OVL-së, të 23
20 anëtarët me shumicë votash. Sa më kujtohet votimi nëse duhej
21 të publikoheshin dokumente të tilla ishte unanimitet. Hysniu,
22 Nasimi dhe Fatoni vetëm sa e kanë zbatuar vendimin e kryesisë.
23 OVL-ja ka qenë gjithmonë kundër Dhomave të Specializuara të
24 Kosovës (DHSK) dhe mendonim që këto dokumente që ishin sjellë
25 ishin të lidhura me serbët. DHSK-ja konsideron secilin veteran

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 111

1 shqiptar si terrorist.

2 Më 17 shtator 2020, isha në zyrat e OVL-së. Isha duke
3 ndihmuar lidhur me kartelat e anëtarësisë në atë kohë dhe isha
4 i pranishëm kur në zyra erdhi Zyra e Prokurorit të
5 Specializuar. Kartelat e anëtarësisë mund të bëhen vetëm në
6 Prishtinë. Anëtarëve iu duhen ato sepse i ndihmojnë për
7 shërbime shëndetësore pa pagesë. Prandaj unë i sjell kërkesat
8 në Prishtinë në mënyrë që t'i përgatisin kartelat e
9 anëtarësisë aty.

10 Atë ditë, isha në dhomën e katit të katërt ku ishte stafi
11 teknik, Taibe Miftari dhe Elvir Gucati. Dhoma ishte në katin e
12 njëjtë me zyrat e tjera.

13 Rreth përfaqësuesit orës 11.00 ZPS-ja arriti në zyra. Ata
14 qëndruan përfaqësuesit dy deri në tre orë. Nuk kam folur me
15 askënd nga ZPS-ja, vetëm e kam vëzhguar situatën. Hysni Gucati
16 dhe Nasim Haradinaj ishin personat që kanë folur me ZPS-në.
17 Por unë isha i pranishëm në zyrën e Hysniut me ta.
18 Në fund dokumentet iu dorëzuan ZPS-së. Atë ditë i kisha
19 shikuar sipërfaqësisht dokumentet. Sillesha andej dhe në
20 fillim isha me stafin teknik dhe ndoshta i kam ndihmuar ata
21 t'i bartin dokumentet në zyrën e Hysniut. Ishte një paketë me
22 dokumente. ZPS-ja e nënshkroi dokumentin që unë mendoj se
23 ishte dokument për dorëzimin, por unë kurrë personalisht nuk e
24 kam parë këtë dokument. ZPS-ja pastaj e mori paketën dhe u
25 largua nga zyrat.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 112

1 Dua të them që do të doja që unë të isha i burgosur në Hagë në
2 vend të Hysniut dhe Nasimit. Hysniu është i plagosur në këmbë.
3 Ka shufra në këmbë dhe vuan nga diabeti kronik. Sa i përket
4 Nasimit nuk njoh ndonjë familje tjetër në Kosovë që ka vuajtur
5 më shumë se familja e Nasimit, prindërit e tij, bashkëshortja
6 dhe vëllezërit dhe motrat, të gjithë kanë qenë në burg. Nasimi
7 nuk mund të japë më shumë se kaq.

8 E di që Tomë Gashi është avokat që e ka këshilluar OVL-në
9 pas sjelljes së dytë të paligjshme të dokumenteve. Sa di unë,
10 Tomë Gashi nuk e përfaqëson më OVL-në për shkak të angazhimeve
11 të tjera personale. Por ndihma e tij ishte pa pagesë dhe për
12 këtë e falënderojmë.

13 I kam parë videot e sjelljes së tretë të paligjshme të
14 dokumenteve në OVL. Jam njoftuar, jam njoftuar për incidentin
15 përmes mediave. Storia është shfaqur në të gjitha kanalet
16 mediale të Kosovës.

17 Në ditën kur janë arrestuar Hysniu dhe Nasimi, miqtë në
18 Malishevë i kanë parë lajmet për arrestimin e tyre në Facebook
19 dhe më kanë informuar. Pastaj kam udhëtuar për në Prishtinë,
20 një vozitje 40-minuta për të parë çfarë ishte duke ndodhur.

21 E ndjeva që ishte obligim i imi. Kur arrita në zyrat e
22 OVL-së u përpoqa të hyja brenda por nuk më lejuan. Policia
23 ndërkombëtare, EULEX-i e kishte bllokuar hyrjen.

24 Për më tepër, Nasimi nuk ishte përpjekur të ikte ditën e
25 arrestimit të tij. Ai ishte duke shkuar në drejtim të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 113

1 Prishtinës. Nasimi më ka lutur që ta qetësoj situatën në ditën
2 e arrestimit të tij.

3 Jam i gatshëm të shkoj në Gjykatë në Hagë për të dhënë
4 dëshmi.

5 Kjo është përmbajtja e përmbledhjes së deklaratës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jam në
7 dijeni që ju nuk keni kundërshtim, keni tërhequr pra
8 kundërshtimin që kishit për kundërshtimin e ZPS-së. Trupi
9 Gjykues e pranon deklaratën e zoti Metush Kryeziu, në kuadër
10 të rregullores me përjashtim të paragrafit 19 dhe 20, për të
11 cilët ka kundërshtim ZPS-ja.

12 Pra Trupi Gjykues vë re se pjesa tjetër e deklaratës ka
13 lidhje me çështjen dhe ka vlerë provuese dhe akuzat që ngrihen
14 kundër të akuzuarve.

15 Për më tepër zoti Kryeziu ndodhet në sallë. Është i
16 gatshëm për kundërpjetje dhe pyetje të tjera t'i bëjë Trupi
17 Gjykues. Ai gjithashtu ka vërtetuar se deklarata me shkrim
18 pasqyron me saktësi atë që do të dëshmonte në sallë, prandaj
19 dhe Trupi Gjykues e pranon në provat gjyqësore këtë deklaratë
20 me klasifikim publik dhe numri që i caktohet është 1D8.

21 Z. Bowden, keni ndonjë pyetje tjetër.

22 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje të tjera, por
23 dëshiroj të theksoj se duket që transkripti i drejtpërdrejtë
24 nuk funksionon më. Nuk e di a është në ekranin tim apo në
25 gjithë sallën.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 114

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kështu më
2 duket edhe mua. Nëse mund ta verifikojmë si është puna.

3 Z. BOWDEN: [Përkthim] Por nuk kemi pyetje të tjera
4 gjithsesi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
6 Transkripti në ekranin tim funksionon. Nuk e di për të tjerët.
7 Nuk e di a funksionon.

8 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo, nuk funksionon.

9 Nuk e di a duhet ta fikim a ta ndezim sipas rekomandimeve
10 të zoti Worboys.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më mirë ta
12 bëjë zoti Worboys këtë punë, jo ne.

13 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
14 këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk e di a
16 ekranet e tjerë...Jo, jo? I askujt. Në rregull.

17 Z. PACE: [Përkthim] Për të mos penguar procedurën, nëse
18 mund të thotë avokati i Mbrojtjes që s'ka pyetje edhe ne, edhe
19 unë s'kam pyetje, mbase kjo na çon edhe në pauzë për t'i bërë
20 një rifreskim nëse për t'i informuar të gjithë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, unë
22 kam pyetje vetë. Nuk e di nëse të tjerët kanë.

23 Zoti Worboys, ju keni?

24 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Metush Kryeziu (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 115

1 Prokuroria?

2 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërpyetje, nëse nuk del
3 ndonjë gjë tjetër nga pyetjet që vijnë pas këtij momenti. Ne
4 nuk kemi pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Anëtarët e
6 Trupit Gjykues kanë pyetje?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Kryeziu,
8 përfundoi këtu dëshmia juaj. Mund të largoheni tani. Ju urojmë
9 ditën e mirë.

10 Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqëroheni
11 dëshmitarin të dalë nga salla.

12 DËSHMITARI: Mund me e marrë këtë dokument me vete?

13 [Dëshmitari largohet]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Besoj se
15 për sot me dëshmitarët mbaruam.

16 Zoti Worboys, më herët sot thatë se keni ca informacione
17 për ne në fund të punimeve sot për planet për javën tjetër.

18 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Lajmi i
19 mirë sigurisht është që do të jemi në gjendje që të mbajmë
20 deklaratën hyrëse javën e ardhshme, pavarësisht nga gjendja e
21 zotit Cadman.

22 Kemi bërë kërkimet tona për dëshmitarët. Gjatë drekës kam
23 dijeni që dëshmitari 1206 [sipas përkthimit] mendohet se do
24 mbërrijnë në Hagë të martën në mbrëmje. Për këtë arsye do të
25 jetë në gjendje, pra do të jetë i disponueshëm javën e

1 ardhshme.

2 Sa i takon dëshmitarit të dytë. Të nderuar Gjykatës kam
3 bërë një përllogaritje. Në bazë të kohës që kemi për vitin e
4 ri dhe sipas çmuarjeve tona, vlerësimi për zoti Haradinaj janë
5 rreth tre ditë Vlerësimi për dëshmitarin 1254 është rreth
6 katër orë. Dhe vlerësimi për dëshmitarin 1252 është dy orë.

7 Jam në dijeni se në janar kemi katër ditë e gjysmë. Nëse
8 këtë vlerësimë janë të sakta dhe unë parashtroj edhe në bazë
9 të aktiviteteve që janë sot, besoj se janë të sakta, jemi të
10 qëndrimit se është e mundshme që t'i dëgjojmë këta dëshmitarë
11 brenda hapësirës që kemi në vitin e ri.

12 Duke pasur parasysh dhe mungesën e zotit Cadman, i lutemi
13 Trupit Gjykues që të na japë lejen që të dëgjojmë dëshmitarin
14 1236 javën e ardhshme së bashku me deklaratën hyrëse.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po pse jo
16 1254 të paktën?

17 Z. WORBOYS: [Përkthim] Dëshmitari 1254 në mungesën e
18 zotit Cadman, që mendojmë se kështu do jetë, ai do mungojë, ne
19 si ekipi mbrojtës preferojmë, duke pasur parasysh dhe
20 mundësitë e kohës vitin e ardhshëm dhe pa cenuar procesin
21 gjyqësor që të mbyllet brenda datës që është menduar, mendojmë
22 ta dëgjojmë atëherë kur të jetë kthyer dhe zoti Cadman.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja Bolici,
24 zoti Pace, sa u takon dy dëshmitarëve që do të rithirren për
25 kundërpjetje janë të disponueshëm të mërkurë, të

1 enjte, të premte?

2 Z. PACE: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Të tria
4 ditët.

5 Do të preferonim të dëgjohen që të mërkurën në mëngjes
6 brenda një periudhe të shkurtër.

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Dua
8 të vë re që ne nuk kemi dëgjuar asnjë arsye të vlefshme pse të
9 mos vijojmë siç ka kërkuar i nderuar Gjykatës dje. Zoti
10 Haradinaj është i përfaqësuar në mënyrë mëse adekuate nga
11 bashkëmbrojtësi dhe nga avokati i tanishëm. Ne jemi në dijeni
12 të ngjarjeve nëse do të përdoret koha që është vendosur ne
13 dispozicion. Javën e ardhshme do të ishte në interesin më të
14 mirë të të gjithëve që të përdorej kjo kohë. Dhe ne si ZPS
15 jemi të gatshëm që të procedojmë, të vijojmë pra me
16 dëshmitarët tani dhe javën e ardhshme jemi të gatshëm që të
17 bëjmë kundërpyetje.

18 Dua që të vë re edhe diçka. Do të ketë një parashtrim të
19 protokolluar sa i takon kalendarit të dëshmisë së
20 dëshmitarëve, të dy dëshmitarëve të Prokurorisë, të cilën do
21 jua njoftojmë pas pak kohe sot. Pra një parashtrim i
22 protokolluar të cilin mendojmë ta dorëzojmë sot.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Për të
24 qenë të saktë kemi katër ditë e gjysëm në janar dhe me gabimin
25 më të vogël do të ndodheshim në një pozitë të vështirë që të

1 mos, nuk do ta përfundonim dot çështjen në mes të janarit. Dhe
2 ky ka qenë qëllimi. Është qëllimi tani, ka qenë qëllimi që
3 ditën e parë.

4 Kështu që besoj se ne do të kuvendojmë...

5 Z. WORBOYS: [Përkthim] Edhe një argument të fundit që
6 desha ta them përpara ndërhyrjes së ZPS-së. Sigurisht për të
7 ndihmuar në efikasitet këtë javë dhe në janar, ne do të
8 përpiqemi gjithashtu të mbështetemi në rregullin 154.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Mikrofoni
10 çaktivzuar]

11 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mund të ketë lidhje
12 dhe me kuvendimet tuaja. Por lidhur dhe me atë që tha Z.
13 Worboys, a mund të sqarohemi nëse do të përdoret apo jo
14 rregulli 154 sa i takon dëshmisë së vetë zoti Haradinaj. Nëse
15 nuk do të përdoret rregulli 154, cili është vlerësimi i
16 përditësuar? Ju përmendët të nderuar Gjykatës katër ditë e
17 gjysmë në janar, mirëpo kjo do të kishte një ndikim shumë të
18 madh sa i takon pyetjeve kryesore.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Për cilët
20 do përdorni rregullin 154.

21 Z. WORBOYS: [Përkthim] Hë për hë propozojmë që të
22 përdorim javën e ardhshme në lidhje me 1246, 1254 në vitin e
23 ri, pra pas vitit të ri dhe mbase dhe me 1252-shin.

24 Do të më duhet që të marr udhëzime se ç'qëndrim mban dhe zoti
25 Haradinaj, po mendojmë se do t'ia dalim mbanë që t'i kryejmë

1 këta në ditët që kemi në dispozicion vitin e ardhshëm.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne do të
3 bëjmë kuvendime për këtë dhe pas pak do kthehemi t'ju japim
4 përgjigje.

5 --- Pauza fillon në orën 15.20

6 --- Seanca rifillon në orën 15.29

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sipas
8 rregullit 149, zonja Myers duhet të vijë personalisht por nuk
9 mund të trajtohet mbështetur në rregullin 154. Ne pa diskutim
10 që jemi të gatshëm që të bëjmë dhënien e dëshmisë së saj
11 përmes Zoom-it n.q.s. kjo do të ndihmonte.

12 Pjesë e problemit është që numri i orëve që mund të na
13 kërkohet për të bërë këtë gjë në janar siç e thashë më përpara
14 mund të na vë në vështirësi dhe ndoshta na e bën të pamundur
15 që ta mbyllim çështjen ashtu siç ishte planifikuar. Kështu që
16 duhet të përgatiteni që të keni dy dëshmitarë javën që vjen.
17 Se cilët janë këta dëshmitarë, varet tërësisht me juve, por
18 nga ana tjetër n.q.s. vendosni që të jepet dëshmia përmes
19 Zoom-it, mund të bëjmë dhe organizimin e duhur. Kështu që
20 duhet që të përfundojmë me dy dëshmitarët dhe pastaj të
21 vijojmë me pjesën tjetër në vitin e ri, pas vitit të ri.

22 Pra të hënën në mëngjes duhet që t'i keni dëshmitarët
23 këtu. Jo më falni nuk e kam për të hënën e kam fjalën për të
24 mërkurën.

25 Pra të mërkurën pasdite do të jetë hapja.

1 Z. Rees.

2 Z. REES: [Përkthim] Ju lutem a mund t'ju kërkoj disa
3 udhëzime të tjera dhe këto udhëzime kanë të bëjnë me zotin
4 Çelë Gashi. Dhe do të na ndihmonit në qoftë se do të kemi
5 njoftim paraprak lidhur me mënyrën sesi do të merret në pyetje
6 ai prej nesh. Ne kërkojmë që pjesë të deklaratës të reduktohen
7 sipas rregullit 149 [sipas përkthimit], me kushtin që
8 dëshmitari vërteton dhe thotë që deklarata është e vërtetë.
9 Por ne do të kërkojmë që deklarata e tij të mund të pranohet e
10 tëra në përjashtim të paragrafit 17 [sipas përkthimit], pra
11 paragrafi 32 dhe paragrafi 34.

12 Ne nuk kërkojmë pranim të këtyre paragrafëve që sapo i
13 citova, kështu që ZPS-ja nuk duhet që të bëjë një kundërshtim
14 zyrtar lidhur me këta paragrafë.

15 Sa i takon paragrafëve 20 dhe 22, të cilët janë
16 paragrafët e tjerë të vetëm, për të cilët ZPS-ja ka ngritur
17 problem, ne nuk mendojmë që këta paragrafë përmbajnë
18 informacion i cili nuk është i rëndësishëm. Sipas nesh këta
19 paragrafë përmbajnë informacion të rëndësishëm. Ne do të
20 konfirmojmë nesër në momentin kur të fillojë dëshminë ky
21 dëshmitar dhe ne rrethana, në të cilat ato janë të ndryshme
22 nga ato çfarë nga ZPS-ja, megjithatë do të doja të thoja
23 paraprakisht që nuk ka arsye për neve që të mos i drejtohem
24 rregullit 154. Dhe ZPS-ja të mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit
25 lidhur me këta dy paragrafë. Ndryshe nga 154-a, rregulli 153,

1 i kërkon dëshmitarit të jetë i pranishëm për të bërë pyetje
2 dhe për të sqaruar pjesë të caktuara të cilat janë të
3 diskutueshme.

4 Pra 16, 32 deri në 34 [sipas përkthimit], janë
5 paragrafët, të cilët ne mendojmë që ndoshta nuk janë të
6 rëndësishëm për arsye të deklaratës ndërkohë që do të kërkojmë
7 pjesën e mbetur të të gjithë deklaratës që të pranohet.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra 16,
9 32, dhe 34 janë paragrafët që ju thoni që doni të përjashtoni
10 apo jo?

11 Z. REES: [Përkthim] Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Pace
13 apo nuk e di kush është përgjegjës për këtë pjesë.

14 Zoti Halling.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Duket sikur jam unë. Po, ne do të
16 kundërshtojmë paragrafët 20 dhe 22. Është e parakohshme për
17 momentin se rregulli 154 nuk janë përmbushur. Megjithatë mund
18 ta cekim sot këtë ose nesër.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Çfarë
20 kundërshtim keni ju? Cili është kundërshtimi juaj?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtimi është që natyra e
22 këtyre fakteve konkrete jepet spontanisht më mirë në gjyq dhe
23 parimi i parashtrimeve gojore është më me vend këtu sesa
24 thjesht të prezantohen prova të tilla në mënyrë shkresore.

25 Kjo nuk është prova jonë. Nuk janë dokumentet tona. Ne nuk do

1 kemi mundësi që të bëjmë pyetje, por mendoj që është më me
2 vend d.m.th. që pyetjet të bëhen në mënyrën që ne përshkruam
3 pak më parë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund t'i
5 pranoj të gjitha provat, në përjashtim të paragrafit 20 dhe 22
6 dhe pastaj t'ju vëmë në dispozicion dëshmitarët n.q.s. doni ta
7 bëni në këtë mënyrë.

8 Z. REES: [Përkthim] Pra parimi i dëshmisë gojore
9 sigurohet mbi bazën e rregullit 154 dhe dëshmitari duhet të
10 jetë i gatshëm që t'i japë përgjigjet për ato pjesë të cilat
11 nuk i pranon ZPS-ja.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Është një
13 çështje interesante. Do ta diskutojmë sonte. Do ju japim një
14 përgjigje po aq interesante nesër.

15 Z. REES: [Përkthim] A do të thotë kjo që kërkesa për
16 udhëzime për të planifikuar paraprakisht nuk u përgjigj?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kemi këto të
18 dyja që duhet që të diskutojmë dhe të marrim një vendim dhe më
19 vjen keq që nuk mund t'ju jap më shumë udhëzime sesa kaq. Na
20 humbët gjithë këtë kohë për asgjë.

21 Zoti Pace.

22 Z. PACE: [Përkthim] Po flasim ndërkohë për planifikimin
23 kështu që do të doja të dija n.q.s. është e mundur nga
24 Mbrojtja e z. Haradinaj se kush do të jenë dëshmitarët
25 potencialë javën që vjen sepse kjo do të na ndihmonte shumë në

1 mënyrë që të përgatiteshim për javën që vjen. Pra nuk e di
2 n.q.s. mund të na thotë Mbrojtja e z. Haradinaj ose n.q.s. jo,
3 nesër do të ishte mirë në mënyrë që të përgatiteshim siç
4 duhet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A jeni në
6 pozicion për ta thënë këtë gjë?

7 Z. WORBOYS: [Përkthim] Do të ishte më mirë që t'jua them
8 nesër. Nesër në mëngjes do ju themi, pra do i themi ZPS-së
9 përpara se të fillojë procesi gjyqësor nesër se cilët do të
10 jenë dëshmitarët javës që vjen.

11 Z. WORBOYS: [Përkthim] Ndërkohë që jam në këmbë a mund të
12 ngre dy çështje të tjera të vogla ju lutem.

13 Juve thatë që hapja do të jetë pasdite të mërkurën. Por
14 unë e kuptova, nuk e di është e saktë kjo apo jo, sepse unë
15 kisha kuptimin që ne kemi dy seanca paradite të mërkurën.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, e
17 vërtetë është. E ke ti të saktë. Kam përshtypjen që z. Cadman
18 tha që hapja është vetëm një orë.

19 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po, e saktë është kjo. Por pyetja
20 ime ishte që ne seancë kemi vetëm paradite, nuk kemi pasdite
21 siç e thatë ju më përpara apo jo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kemi vetëm
23 dy seanca paradite. Nuk ka asgjë pasdite, kështu që do të kemi
24 kohë të mjaftueshme për t'i bërë të dyja. N.q.s. për ca arsye
25 marrja në pyetje plotësuese nga z. Rees do kërkojë më shumë

1 kohë, atëherë do të duhej që të fillojmë të enjten paradite.

2 Z. WORBOYS: [Përkthim] Faleminderit. Për procesverbal dua
3 të ngre diçka tjetër. Dje ju bëtë një koment sa i takon
4 procesit të rregullit ligjor dhe dua të bëj dy konstatime
5 lidhur me këtë, jo në kuptimin e rihapjes po thjesht sa për
6 procesverbal.

7 Çështja e parë është që në faqen 115 të transkriptit
8 kishte një koment për thirrje telefonike të bëra nga zoti
9 Haradinaj për avokatin e Mbrojtjes. Unë e kam pyetur zotin
10 Haradinaj dhe më ka thënë që nuk ka bërë asnjëherë thirrje
11 telefonike. Unë personalisht nuk e di se çfarë ka ndodhur. Unë
12 e di që zoti Cadman ka pasur një telefonatë të humbur në
13 telefonin e tij dhe ka pasur temperaturë shumë të lartë dhe
14 thjesht dua të di se cila është situata.

15 Dhe së dyti, nuk dua të hap ndonjë debat lidhur me të,
16 por thjesht dua të them që Mbrojtja ka këtë pozicion sa i
17 takon procesit të rregullit dhe të drejtë në të ardhmen.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Çështja e
19 telefonatave na erdhi drejtpërsëdrejti nga Zyra e
20 Administrimit që bën monitorimin e telefonatave.

21 Mirë atëherë, kemi përfunduar për sot. E mbyllim për sot.
22 Dhe do të takohemi sërish nesër në orën 9.30 të mëngjesit.

23 --- Seanca mbyllet në orën 15.38

24

25